

# Publikationen

zur rechtlichen Zusammenarbeit

Buletini i praktikës gjyqësore të  
Gjykatës Europiane për të Drejtat e  
Njeriut  
Botimi 2/2018, vëllimi i 7-të, viti i 4-të

Aktuelle Rechtsprechung des EGMR  
Newsletter 2/2018



botuar nga  
Enti për përfaqësim te Republikës së  
Maqedonisë së Veriut para GJEDNJ  
dhe  
Fondacioni gjerman për bashkëpunim  
ndërkombëtarë juridik, Shoqatë e  
regjistruar (IRZ)



Република Северна Македонија  
Министерство за правда



## BULETINI I PRAKTIKËS GJYQËSORE TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Botues:

MAKAVEJ Shkup, viti 2019

Përkthimi në gjuhën shqipe:

Koço Bendo (faqe 12-60)

Behar Dalipi (faqe 61-76)

Koordinimi i redaksisë së botimit në gjuhën shqipe: Dr. Stefan Pürner, avokat, dhe Danica Djonova, v.d. Drejtore e Entit për përfaqësimin e RMV-së para GJEDNJ-së.

Bashkëpunimi i redaksisë së botimit në gjuhën shqipe:

Dana Trajčev – Bozhiq, V.A., studime për media dhe komunikime, Luka Prica - Menaxhere Projekti në IRZ-ë dhe Ritta Lideroth, jurist, menaxhues i projektit pranë IRZ

Përkthimi i këtij Buletini në gjuhën shqipe, si dhe botimi i këtij publikimi u mundësua nga ana e Fondacionit gjerman për bashkëpunim ligjor ndërkombëtar, shoqatë e regjistruar (IRZ).

Buletini i praktikës gjyqësore të  
Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut

botuar nga  
Enti për përfaqësimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut  
para GJEDNJ-së

dhe  
Fondacioni gjerman për bashkëpunim ligjor ndërkombëtar  
Shoqatë e regjistruar (IRZ)

Botimi 2/ 2018, vëllimi i 7-të, viti i 4-të, në gjuhën shqipe

~~~~~

Newsletter zur Rechtsprechung des  
Europäischen Gerichtshofs für Menschenrechte

Gemeinsam herausgegeben von dem mazedonischen  
Regierungsvertreter vor dem EGMR

und der  
Deutschen Stiftung für internationale rechtliche  
Zusammenarbeit e.V. (IRZ)

Ausgabe 2/2018, 7. Band, 4. Jahrgang in albanischer Sprache

*Sehr geehrte Kolleginnen und Kollegen, liebe Leser,*

Sie halten eine neue Ausgabe des bereits im vierten Jahr erscheinenden Newsletter zur Rechtsprechung des Europäischen Gerichtshofs für Menschenrechte (EGMR) in Straßburg in Händen. Dieser Newsletter ist zur Information von Justizangehörigen, insbesondere Richtern und Staatsanwälten, und Behördenmitarbeitern in Nordmazedonien gedacht. Deshalb berichtet er vor allem über Urteile des Straßburger Gerichts, die für diese von besonderem Interesse sind, also über Entscheidungen, die gegen Mazedonien ergangen sind, oder aber, obwohl sie aus Verfahren gegen andere Staaten stammen, sich auf Rechtsfragen beziehen, die in Nordmazedonien große praktische Bedeutung haben.

Herausgegeben wird dieser Newsletter, der in mazedonischer und albanischer Sprache erscheint, gemeinsam von der Regierungsvertreterin von Nordmazedonien und Direktorin des Büros für die Vertretung Nordmazedoniens vor dem EGMR und der Deutschen Stiftung für internationale rechtliche Zusammenarbeit e.V. (kurz IRZ).

Bei der IRZ handelt es sich um eine seit 1992 bestehende Organisation, die im Auftrag der deutschen Bundesregierung Transformationsstaaten bei den Reformen hin zum Rechtsstaat unterstützt. In der IRZ sind die wichtigsten deutschen Organisationen, die im Bereich des Rechtsstaates und der Justiz tätig sind, zusammengeschlossen. Dazu gehören (in alphabetischer Reihenfolge gemäß ihrer Bezeichnung in deutscher Sprache) der Bund Deutscher Rechtspfleger e.V., der Bund Deutscher Verwaltungsrichter und Verwaltungsrichterrinnen, die Bundesnotarkammer, die Bundesrechtsanwaltskammer, der Deutsche Anwaltverein e.V., die Deutsche Institution für Schiedsgerichtsbarkeit e.V., der Deutsche Juristinnenbund e.V. der Deutsche Notarverein e.V., der Deutsche Richterbund e.V. und die Notarkammer Koblenz.

Eine weitere Gruppe von Mitgliedern bilden wirtschaftliche Vereinigungen, wie der Bundesverband der Deutschen Industrie e.V., der Bundesverband deutscher Banken e.V., der Bundesverband der Unternehmensjuristen e.V., der Deutsche Genossenschafts- und Raiffeisenverband e.V., der Deutsche Industrie- und Handelskammertag e.V., der Gesamtverband der Deutschen Versicherungswirtschaft e.V., der Markenverband e.V., und der Osteuropaverein der deutschen Wirtschaft e. V.

Hinzu kommen bedeutende Industrieunternehmen wie die Allianz SE, die Bayer AG und die Daimler AG sowie eine Anzahl von Einzelpersonen aus Justiz, Politik und Wissenschaft.

In Nordmazedonien ist die IRZ seit dem Jahr 2000 mit Mitteln des deutschen Auswärtigen Amtes (AA) aus dem deutschen Beitrag zum Stabilitätspakt für Südosteuropa tätig. Darüber hinaus wird die Tätigkeit der IRZ allgemein, aber auch in Südosteuropa, durch

*Shumë të nderuar kolege dhe kolegë, të dashur lexues,*

po merrni në dorë botimin e ri të buletinit në vitin e tij të katër të publikimit mbi praktikën gjyqësore të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) në Strasburg. Ky buletin është menduar për informimin e operatorëve të drejtësisë, veçanërisht gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe punonjësve të organeve administrative në Maqedoninë e Veriut. Për këtë arsye ai përmban para së gjithash vendime të Gjykatës së Strasburgut që për ta paraqesin interes të veçantë, pra vendime të cilat janë dhënë kundër Maqedonisë së Veriut ose nga gjykime të tjera kundër shteteve të tjera, por që prekin çështje ligjore të cilat për Maqedoninë e Veriut janë me rëndësi të madhe praktike.

Ky buletin, i cili del në gjuhët maqedonase dhe shqipe, botohet në bashkëpunim me përfaqësuesen e qeverisë maqedonase dhe Drejtorinë e Agjencisë për përfaqësimin e Maqedonisë së Veriut para GJEDNJ-së dhe Fondacionit Gjerman për Bashkëpunim ligjor ndërkombëtar (shkurt IRZ).

IRZ-ja është një organizatë që është themeluar në vitin 1992, e cila, në emër të Qeverisë Federale Gjermane, mbështet shtetet në transformim e sipër në reformat e tyre drejt shtetit të së drejtës. Në IRZ-ë përfaqësohen organizatat gjermane më të rëndësishme të cilat veprojnë në sferën e shtetit të së drejtës dhe drejtësisë. Këtu përfshihen (në renditje alfabetike sipas emërimit në gjuhën gjermane) Lidhja Gjermane e Punonjësve Gjyqësorë (der Bund Deutscher Rechtspfleger e.V.), Lidhja Gjermane e Gjyqtarëve dhe Gjyqtareve për Çështjet Administrative (der Bund Deutscher Verwaltungsrichter und Verwaltungsrichterin), Dhoma Federale e Noterisë (die Bundesnotarkammer), Dhoma Federale e Avokatisë (die Bundesrechtsanwaltskammer), Shoqata Gjermane e Avokatëve (der Deutsche Anwaltverein e.V.), Institucioni gjerman i Arbitrazhit (die Deutsche Institution für Schiedsgerichtsbarkeit e.V.), Lidhja gjermane e Juristëve (der Deutsche Juristinnenbund e.V.), Shoqata Gjermane e Noterëve (der Deutsche Notarverein e.V.), Lidhja Gjermane e Gjyqtarëve (der Deutsche Richterbund e.V.) dhe Dhoma e Noterisë Koblenz (die Notarkammer Koblenz).

Një grup tjetër i anëtarëve përbëhet nga organizimet ekonomike si Shoqata Federale e Industrisë Gjermane (der Bundesverband der Deutschen Industrie e.V.), Shoqata Federale e Bankave Gjermane (der Bundesverband deutscher Banken e.V.), Shoqata Federale e Juristëve të Ndërmarrjeve (der Bundesverband der Unternehmensjuristen e.V.), Shoqata Gjermane e Kooperativave dhe Raiffeisen-it (der Deutsche Genossenschafts- und Raiffeisenverband e.V.), Kongresi i Dhomës Gjermane të Industrisë dhe Tregtisë (der Deutsche Industrie- und Handelskammertag e.V.), Shoqata e Përgjithshme e Ekonomisë Gjermane të Sigurimeve (der Gesamtverband der Deutschen Versicherungswirtschaft

eine institutionelle Zuwendung des deutschen Bundesministeriums der Justiz und für Verbraucherschutz (BMJV) ermöglicht.

Im Rahmen dieser Tätigkeit spielen die Menschenrechte und die Europäisierung des Rechtes eine besondere Rolle. Außer Gesetzgebungsberatung und Unterstützung bei der Aus- und Weiterbildung von Juristen arbeitet die IRZ auch auf dem besonders nachhaltigen Feld juristischer Publikationen. So erscheint in Nordmazedonien zusätzlich zu diesem Newsletter bereits seit dem Jahre 2011 eine juristische Fachzeitschrift zum Europarecht, die unter <http://www.evropsko-pravo.info> auch eine eigene Internetseite besitzt, von der alle bisher erschienenen Ausgaben dieser Zeitschrift heruntergeladen werden können. Auch ist es dort möglich, einzelne Beiträge gezielt herunterzuladen.

Auch der vorliegende Newsletter wird in elektronischer Form vertrieben. So findet sich die mazedonische Fassung auf der Internetseite der IRZ unter <https://www.irz.de/index.php/downloads#publikationen-in-mazedonischer-sprache-публикации-на-македонски-јазик> und die albanische unter <https://www.irz.de/index.php/downloads#publikime-n%C3%AB-gjuh%C3%ABn-shqipe-publikationen-in-albanischer-sprache>. Darüber hinaus werden alle Ausgaben des Newsletters auch auf der Internetseite des Büros für die Vertretung Nordmazedoniens vor dem EGMR unter <http://biroescp.gov.mk> in der Rubrik „Sudska praksa“ (Rechtsprechung) zum Herunterladen angeboten. Dort finden sich auch alle andere Urteile des EGMR gegen Nordmazedonien in mazedonischer Übersetzung.

Durch die elektronische Publikation wird der Newsletter allen Interessierten zugänglich. Die Angehörigen der mazedonischen Justiz erhalten ihn darüber hinaus in Druckform. Die wichtigste Rechtsprechung des EGMR ist deshalb mithilfe dieses Newsletters jedem Richter und Staatsanwalt Nordmazedoniens zeitnah direkt auf seinem eigenen Schreibtisch zugänglich.

Die Herausgeber des Newsletters haben bewusst verschiedene Verbreitungswege gewählt, um einen möglichst großen Adressatenkreis erreichen zu können. Dies deshalb, da die Rechtsprechung des Straßburger EGMR für die Anwendung des jeweiligen nationalen Rechts von erheblicher Bedeutung ist. Außerdem garantiert sie, dass die gemeinsamen Menschenrechtsstandards der im Europarat zusammengeschlossenen Staaten auch in der Praxis tatsächlich eingehalten werden.

Ein so anspruchsvolles und nachhaltiges Unternehmen wie die bereits jahrelange regelmäßige Herausgabe eines aktuellen Newsletters in zwei Sprachen ist nur durch das Engagement aller Beteiligten, Teamwork und dauerhafte Unterstützung möglich.

e.V.), Shoqata e Markave, Berlin (der Markenverband e.V., Berlin) dhe Shoqata e Europës Lindore e Ekonomisë Gjermane (der Osteuropaverein der deutschen Wirtschaft e. V.).

Këtu përfshihen edhe ndërmarrjet e rëndësishme industriale Allianz SE, Bayer AG dhe Daimler AG si dhe një numër personalitetesh nga drejtësia, politika dhe shkenca.

Në Maqedoninë e Veriut IRZ-ja e ka filluar aktivitetin e saj në vitin 2000 me fondet e Ministrisë gjermane të Punëve të Jashtme nga kontributi gjerman për Paktin e Stabilitetit për Europën Juglindore. Përveç kësaj, aktiviteti i IRZ-së në përgjithësi, por edhe për Europën Juglindore, mundësohet nëpërmjet një kontributi institucional të Ministrisë Federale gjermane të Drejtësisë dhe për Mbrojtjen e Konsumatorit (MFDK).

Në kuadrin e këtij aktiviteti të drejtat e njeriut dhe europianizimi i së drejtës luajnë një rol të veçantë. Përveç këshillimeve në hartimin e legjislacionit dhe mbështetjes në trajnimin fillestar dhe të vazhduar të juristëve, IRZ-ja punon veçanërisht në sferën qëndrueshme të publikimeve juridike. Kështu në Maqedoninë e Veriut, përveç këtij buletini qysh nga viti 2011 botohet edhe një revistë juridike mbi të drejtën europiane e cila tek adresa <http://www.evropsko-pravo.info> ka edhe një faqe të vetën, nga e cila mund të shkarkohen të gjitha botimet e deritanishme të kësaj reviste. Edhe atje është e mundur të shkarkohen artikuj të veçantë.

Edhe ky buletin do të botohet në format elektronik. Kështu versioni në maqedonisht gjendet në faqen e internetit të IRZ-së tek adresa <https://www.irz.de/index.php/downloads#publikationen-in-mazedonischer-sprache-публикации-на-македонски-јазик> dhe versioni në shqip tek adresa <https://www.irz.de/index.php/downloads#publikime-n%C3%AB-gjuh%C3%ABn-shqipe-publikationen-in-albanischer-sprache>. Përveç kësaj, të gjitha botimet e buletinit ofrohen për tu shkarkuar edhe në faqen e internetit të Agjencisë për përfaqësimin e Maqedonisë para GJEDNJ-së tek adresa <http://biroescp.gov.mk> në rubrikën „Sudska praksa” (Praktika gjyqësore). Atje gjenden edhe të gjitha vendimet e tjera të GJEDNJ-së kundër Maqedonisë së Veriut të përkthyer në maqedonisht.

Nëpërmjet botimit elektronik buletini është i aksesueshëm nga të gjithë të interesuarit. Operatorëve të drejtësisë maqedonase ai u jepet edhe në format fizik. Nëpërmjet këtij buletini i vihet në dispozicion çdo gjyqtari dhe prokurori maqedonas praktika më e rëndësishme e GJEDNJ-së në kohë të afërt dhe drejtpërdrejt në tavolinën e tij të punës.

Botuesit e buletinit kanë zgjedhur në mënyrë të ndërgjegjshme disa variante publikimi, për të arritur një rreth sa më të gjerë të interesuarish. Kjo për shkak se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së së Strasburgut është e një rëndësie të veçantë për zbatimin e së drejtës përkatëse të brendshme. Përveç kësaj, ajo garanton që standardet e përbashkëta të të



Allen voran gilt es dem deutschen Auswärtigen Amt für die finanzielle Unterstützung, ohne die die Publikation, die sie derzeit in Händen halten, nicht entstehen hätte können, zu danken. Ergänzt wird diese Unterstützung aus Berlin durch das Engagement der deutschen Botschaft vor Ort in Skopje, die die Tätigkeit der IRZ aktiv und engagiert begleitet. Deshalb gilt Herrn Botschafter Thomas Gerberich und seinen Mitarbeitern an dieser Stelle ein herzliches Wort des Dankes. Zu danken haben die Herausgeber auch dem deutschen Ministerium der Justiz und für Verbraucherschutz (BMJV), das die Arbeit der IRZ mit einer institutionellen Zuwendung überhaupt erst ermöglicht.

Besonderen Dank schulden die Herausgeber den Übersetzern, die sich regelmäßig der nicht leichten Aufgabe stellen, die hier zusammengefassten anspruchsvollen juristischen Texte in die genannten Sprachen zu übertragen.

Desweiteren ist auch den Mitarbeitern, die in den beteiligten Organisationen an der Erstellung dieses Newsletters mitgewirkt haben, zu danken. Dies sind bei der IRZ Frau Dana Trajčev Božić, die diese Publikation in Bonn als Projektmanagerin Bonn betreut und Frau Natascha Andreevska-Tomovska, die in Skopje vor Ort für die IRZ die Koordination mit dem Projektpartner, den Übersetzern und dem Verlag übernommen hat.

Zuallerletzt ist noch den Lesern zu danken, die durch ihr bereits seit Jahren anhaltendes Interesse dazu beigetragen haben, dass dieser Newsletter ein Erfolg wurde. Diese Anerkennung ist uns Ansporn, die Herausgabe dieser Publikation auch in Zukunft in der bisherigen Qualität fortzusetzen.

Bonn/Skopje, im September 2018

***Danica Djonova LL.M***  
*Kommissarische Direktorin des Büros  
für die Vertretung Nordmazedoniens  
vor dem EGMR*

***Rechtsanwalt Dr. Stefan Pürner***  
*Bereichsleiter der IRZ  
für Bosnien und Herzegowina, Montenegro,  
Nordmazedonien und Serbien*

drejtave themelore të shteteve palë në Këshillin e Europës të respektohen faktikisht edhe në praktikë.

Një ndërmarrje e tillë ambicioze dhe e qëndrueshme siç është botimi i rregullt për vite me radhë e një buletini të përditësuar në dy gjuhë është e mundur vetëm nëpërmjet angazhimit të të gjithë pjesëmarrësve, punës në ekip dhe mbështetjes së vazhdueshme.

Para së gjithash i duhen shprehur falënderimet Ministrisë gjermane të Punëve të Jashtme për mbështetjen financiare, pa të cilin botimi, të cilin tashme keni në dorë, nuk do të ishte i mundur. Kjo mbështetje nga Berlino plotësohet me angazhimin e ambasadës gjermane në Shkup, e cila ndjek në mënyrë të angazhuar dhe aktivisht aktivitetin e IRZ-së. Për këtë shkak Zotit Ambasador Thomas Gerberich dhe kolegëve të tij me këtë rast i shprehim falënderime të përzemërta. Botuesit duhet të falënderojnë gjithashtu edhe Ministrinë gjermane të Drejtësisë dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (MFDK), e cila ka mundur punën e IRZ-së nëpërmjet një kontributi institucional.

Një falënderim të veçantë botuesit duhet tu shprehin përkthyesve, të cilët marrin përsipër një punë jo të lehtë për përkthimin në gjuhët përkatëse të këtyre teksteve të vështira juridike të përmbledhura .

Më tej një falënderim u shkon edhe kolegëve, të cilët kanë kontribuar në kuadrin e organizatave pjesëmarrësve për përpilimin e këtij buletini. Këta janë në IRZ-ë Zj Dana Trajcevic Bozic, e cila është kujdesur për këtë botim në Bon si menaxhere projekti dhe Zj Nataša Andrejevska-Tomovska, e cila ka marrë përsipër në Shkup për IRZ-në bashkërendimin me partnerët e projektit, përkthyesit dhe shtëpinë botuese.

Pikë së fundi, një falënderim shkon për lexuesit të cilët, për vite me radhë nëpërmjet interesit të tyre kanë kontribuar që ky buletin të kthehet në sukses. Kjo mirënjohje është për ne nxitje për nxjerrjen e këtij botimi edhe në të ardhmen me cilësinë e deritanishme.

Bon/Shkup, shtator viti 2018

**Danica Djonova LL.M.**

*Drejtore e Komanduar e Agjencisë  
për përfaqësimin e Maqedoninë e Veriut  
para GJEDNJ-së*

**Avokat Dr. Stefan Pürner**

*Drejtues i Projektit të IRZ-së  
për Bosnjën dhe Hercegovinën, Maqedoninë e  
Veriut, Malin e Zi dhe Serbinë.*

## Përmbajtja

|                                    |   |
|------------------------------------|---|
| <i>Parathënia e botuesve</i> ..... | 4 |
|------------------------------------|---|

### I. AKTGJYKIMET MË TË REJA TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

|                                                                                                                                                           |    |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| <i>Yrdem dhe të tjerë kundër Turqisë - 72781/12</i> , Vendimi 4.9.2018 (Seksioni II) .....                                                                | 12 |
| <i>S.M. - Kroacia - 60561/14</i> , Vendim Themeli 19.7.2018 (Seksioni II) .....                                                                           | 14 |
| <i>Vasilevskiy dhe/et Bogdanov – Rusi, 52241/14 dhe/et 74222/14</i> ,<br>Vendim themeli 10.7.2018.....                                                    | 18 |
| <i>Kontalexis kundër Greqisë (nr. 2) - 29321/13</i> , Vendim themeli 6.9.2018<br>(Seksioni I) .....                                                       | 20 |
| <i>N.K. – Gjermani/Allemagne, 59549/12</i> , Vendim themeli 26.7.2018 (Seksioni V) .....                                                                  | 23 |
| <i>G.I.E.M. S.r.l. dhe të Tjerë kundër Italisë (GC) - 1828/06, 34163/07 dhe 19029/11</i><br>Vendim themeli 28.6.2018 (GC) .....                           | 26 |
| <i>Jansen kundër Norvegjisë - 2822/16</i> , Vendim themeli 6.9.2018 (Seksioni V) .....                                                                    | 31 |
| <i>Big Brother Watch dhe të tjerë kundër Britanisë së Madhe - 58170/13, 62322/14</i><br><i>dhe 24960/15</i> , Vendim themeli 13.9.2018 (Seksioni I) ..... | 34 |
| <i>Hadzhieva kundër Bullgarisë - 45285/12</i> , Vendim themeli 1.2.2018 (Seksioni V) .....                                                                | 43 |
| <i>Libert kundër Francës - 588/13</i> , Vendim themeli 22.2.2018 (Seksioni V) .....                                                                       | 45 |
| <i>M.L. dhe W.W. kundër Gjermanisë - 60798/10 dhe 65599/10</i> ,<br>Vendim themeli 28.6.2018 (Seksioni V) .....                                           | 48 |
| <i>Savva Terentyev kundër Rusisë - 10692/09</i> , Vendim themeli 28.8.2018 (Seksioni III) ...                                                             | 52 |
| <i>Mushegh Saghatelian kundër Armenisë - 23086/08</i> , Vendim themeli 20.9.2018<br>(Seksioni I) .....                                                    | 55 |

## II. AKTGJYKIMET KUNDËR REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

|                                                                                                                                          |    |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| <b><i>LATIFI kundër Republikës së Maqedonisë</i></b> , A. no. 19017/16,<br>aktgjykimi i datës 17 maj të vitit 2018 .....                 | 61 |
| <b><i>EUROMAK METAL SHPK kundër Republikës së Maqedonisë</i></b> ,<br>A. nr. 68039/14, aktgjykimi i datës 14 qershor të vitit 2018 ..... | 63 |
| <b><i>SEJDIJI kundër Republikës së Maqedonisë</i></b> , A. nr. 8784/11,<br>aktgjykimi i datës 7 qershor të vitit 2018 .....              | 65 |
| <b><i>RAMKOVSKI kundër Republikës së Maqedonisë</i></b> , A. nr. 33566/11,<br>aktgjykim i datës 8 maj të vitit 2018 .....                | 68 |
| <b><i>SMIÇKOVSKI kundër Republikës së Maqedonisë</i></b> , A. nr. 15477/14,<br>aktgjykimi i datës 5 korrik të vitit 2018 .....           | 72 |

## I. AKTGJYKIMET MË TË REJA TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

### NENI 2

#### Neni 2-1:

#### Hetimi i efektshëm

*Yirdem dhe të tjerë kundër Turqisë - 72781/12*, Vendimi 4.9.2018 (Seksioni II)

Moskryerja e procedimit civil dhe penal në lidhje me një vdekje të dyshuar si nga neglizhenca e kujdesit mjekësor brenda një kohe të arsyeshme: *shkelje*

**Faktet** - Kërkuesit pretenduan që i afërmi i tyre kishte vdekur në spital pas një numri rastesh neglizhence mjekësore. Ata pretenduan që gjykatat e brendshme nuk ishin të shpejta, reaguese ose të kujdesshme në masë të mjaftueshme për të trajtuar situatën.

**Ligji** - Neni 2

(a) Aspekti lëndor - përveç rasteve të arbitraritetit ose gabimeve të dukshme, nuk ishte funksioni i Gjykatës të ngrinte pikëpyetje mbi konstatimet e fakteve të bëra nga autoritetet e brendshme. Për pasojë shqyrtimi i rrethanave që sollën vdekjen e të afërmit të kërkuesve dhe përgjegjësia e pretenduar e profesionistëve të kujdesit mjekësor të përfshirë ishin çështjet që duhej të trajtoheshin nga këndvështrimi i përshtatshmërisë së mekanizmave të disponueshëm për të hedhur dritë mbi rrjedhën e ngjarjeve.

Kërkuesit nuk u ankuan që të afërmit të tyre i ishte mohuar aksesimi në trajtimin mjekësor në përgjithësi ose trajtimin e ndihmës së shpejtë posaçërisht, por u ankuan që trajtimi mjekësor i dhënë atij kishte qenë i mangët për shkak të neglizhencës së mjekëve që e kishin trajtuar atë.

Nuk ishin sjellë provat e mjaftueshme për të demonstruar që në momentin përkatës kishin ekzistuar mangësi sistemike ose strukturore që ndikonin

spitalet dhe të cilat diheshin ose duhej të diheshin nga autoritetet dhe në lidhje me të cilat ata nuk kishin marrë masat parandaluese të nevojshme dhe një mangësi e tillë kishte ndikuar në masë vendimtare në vdekjen e të afërmit të kërkuesve.

As nuk u demonstrua që neglizhenca e pretenduar për profesionistët e kujdesit shëndetësor kishte kaluar tej një gabimi ose neglizhence mjekësore ose që ata që ishin përfshirë në trajtimin e të afërmit të kërkuesve, në shkellje të detyrimeve të tyre profesionale, nuk kishin dhënë trajtimin mjekësor të emergjencës megjithëse ishin në dijeni që jeta e tij ishte në rrezik nëse trajnimi nuk do të jepej.

Trajtimi mjekësor i dhënë të afërmit të kërkuesve i ishte nënshtruar shqyrtimit në nivel të brendshëm dhe asnjë nga organet gjyqësore ose disiplinore që kishin shqyrtuar pretendimet e kërkuesve nuk kishte konstatuar përfundimisht ndonjë gabim në trajtimin e tij mjekësor.

Duke patur parasysh konsideratat e mësipërme, Gjykata ishte e mendimit që kjo çështje kishte të bënte me pretendime për neglizhencë mjekësore. Në këto rrethana, detyrimet pozitive lëndore të Shtetit të paditur ishin të kufizuara në ngritjen e një kuadri rregullator të përshtatshëm që ti detyrojë spitalet, qofshin publike apo private, të adoptojnë masat e përshtatshme për mbrojtjen e jetës së pacientëve. Kuadri përkatës rregullator nuk kishte zbuluar ndonjë mangësi në lidhje me detyrimin e Shtetit për të mbrojtur të drejtën e jetës së të afërmit të kërkuesve.

**Përfundim:** nuk ka shkelje (njëzëri)

(b) Aspekti procedural - Kërkuesit kishin mundësinë e dy rrugëve procedurale, një penale dhe një civile, për të arritur të drejtat e tyre. Procedimi penal kishte përfunduar me pafajësinë e të pandehurve pas një procedimi që zgjati mbi nëntë vjet. Procedimi civil kishte mbetur pezull në gjykatat e brendshme qysh nga viti 2004.

Në kuptimin e efektivitetit të procedimit penal, nuk kishte mangësi të tilla që do të vinin në pikëpyetje përshtatshmërinë e përgjithshme të hetimit të zhvilluar nga autoritetet e brendshme. Për më tepër, kërkuesve u ishte dhënë

aksesi në informacionin e dalë nga hetimi në një masë të mjaftueshme për të marrë pjesë në mënyrë të efektshme në gjykim.

Megjithatë, gjykimi penal nuk ishte i shpejtë dhe kohëzgjatja e përgjithshme - mbi nëntë vjet - nuk ishte e arsyeshme. Procedimet e filluara për të hedhur dritë mbi akuzat për neglizhencë mjekësore nuk duhet të zgjasin kaq gjatë para gjykatave të brendshme. E njëjta vlen për gjykimet për zhdëmtim të filluara nga kërkuesit para gjykatave civile, që kishin mbetur pezull para gjykatave të brendshme për më shumë se trembëdhjetë vjet. Nuk gjendej asgjë në dosje që do të sugjeronte që këto gjykime të gjata ishin të justifikuara nga rrethanat e çështjes. Gjykatës Civile të Juridiksionit të Zakonshëm i duhej mbi nëntë vjet për të nxjerrë përfundimin që pretendimi për dëmet në ngarkim të spitalit duhej të ngriheshin tek gjykata administrative dhe që ajo nuk kishte juridiksion për të vendosur për çështjen.

Një kohë e tillë e gjatë kishte zgjatur ankthin e pasigurisë jo vetëm për pretenduesit për edhe për profesionistët mjekësorë të interesuar.

Këto faktorë ishin të mjaftueshëm në vetvete për të nxjerrë përfundimin që procedimet në nivel kombëtar kishin qenë të mangëta. Autoritetet e brendshme nuk e kishin trajtuar pretendimin e kërkuesve që rridhte nga vdekja e të afërmit të tyre në nivelin e kujdesit të kërkuar nga Neni 2 i Konventës.

Përfundimi: shkelje (unanimisht).

Neni 41: 10 000 EURO në lidhje me dëmin jo-financiar; pretendimi në lidhje me dëmin financiar rrëzohet.

## **NENI 4**

### **Trafikimi i qenieve njerëzore**

#### **Detyrime pozitive**

***S.M. - Kroacia - 60561/14***, Vendim Themeli 19.7.2018 (Seksioni II)

## Moskryerja e hetimit të efektshëm mbi akuzat për trafikim të qenieve njerëzore dhe shfrytëzim prostitucioni: shkelje

**Faktet** - Kërkuesja bëri një kallëzim ndaj një të ashtuquajturit T.M., një ish-polic, duke pretenduar që në periudhën ndërmjet verës së vitit 2011 dhe shtatorit të të njëjtit vit ai e kishte detyruar atë fizikisht dhe psikologjikisht në prostitucion. T.M. në vijim u akuzua për detyrimin e një personi tjetër në prostitucion, si një vepër e rëndë penale e prostitucionit të organizuar. Në vitin 2013, gjykata penale e shpalli të pafajshëm T.M. për shkak se, megjithëse ishte e vërtetuar që ai kishte organizuar një rrjet prostitucioni në të cilin ai kishte rekrutuar kërkuesen, nuk ishte vërtetuar që ai e kishte detyruar atë në prostitucion. Ai ishte fajësuar vetëm për formën e theksuar të veprës penale në fjalë dhe kështu ai nuk mund të fajësohej për formën bazë të organizimit të prostitucionit. Ankimi i Zyrës së Prokurorit të Shtetit u rrëzua dhe ankimi kushtetues i kërkueses u deklarua i papranueshëm.

**Ligji** – Neni 4: Trafikimi dhe shfrytëzimi i prostitucionit kërcënon dinjitetin njerëzor dhe liritë themelore të viktimave dhe nuk mund të konsiderohej e pajtueshme me një shoqëri demokratike dhe vlerat e mishëruara në Konventë. U konsiderua e panevojshme të identifikohet nëse trajtimi për të cilin u ankua kërkuesja ishte ‘skllavëri’, ‘nënshtrim’ apo ‘punë e detyruar’. Në vend të kësaj, u nxor përfundimi që trafikimi në vetvete si dhe shfrytëzimi i prostitucionit - brenda kuptimit të Nenit 3(a) të Protokollit të Palermos, Neni 4 (a) të Konventës së Këshillit të Europës për Masat Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (Konventa kundër Trafikimit), Neni 1 të Konventës së OKB-së për Shtypjen e Trafikut të Personave dhe Shfrytëzimit të Prostitucionit të të Tjerëve dhe Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) - përfshihen në objektin e Nenit 4. Në këtë kontekst, nuk kishte rëndësi nëse kërkuesja ishte faktikisht shtetase e Shtetit të paditur dhe që nuk ka element ndërkombëtar meqenëse Neni 2 i Konventës Kundër Trafikimit përfshinte ‘të gjitha format e trafikimit të qenieve njerëzore, qofshin kombëtare ose trans-kombëtare’ dhe Konventa për Shtypjen e Trafikut të Personave dhe Shfrytëzimit të Prostitucionit të të Tjerëve të referuar në shfrytëzimin e prostitucionit në përgjithësi. Gjykata vuri re që ankimet e kërkueses kishin tre aspekte dhe i vlerësoi ato të ndara:



(i) Nëse ka patur një kuadër të përshtatshëm ligjor dhe rregullator - Prostitucioni në Kroaci ishte i paligjshëm. Si shfrytëzimi i prostitucionit duke përfshirë prostitucionin e detyruar, si formë e rënduar e të parit, dhe ofrimi personalisht i shërbimeve seksuale ishin të penalizuara. Veprat penale të trafikimit të qenieve njerëzore, skllavëria, puna e detyruar dhe vepra penale e ndërmjetësimit seksual ishin të ndaluara. Pëlqimi i viktimës ishte i parëndësishëm për ekzistencën e veprës penale të trafikimit të qenieve njerëzore dhe qysh nga viti 2013 kjo ishte e parashikuar shprehimisht në Kodin Penal në lidhje me ndërmjetësimin seksual. Për më tepër, qysh nga viti 2013 blerja e shërbimeve seksuale përbënte një vepër penale. Ndjekja penale në lidhje me të gjitha veprave penale sa më sipër ndërmerrej nga Zyra e Prokurorit të Shtetit. Kodi kroat i Procedurës Penale përmbante gjithashtu dispozita mbi të drejtat e viktimave të veprave penale dhe posaçërisht viktimave të veprave penale kundër lirisë seksuale. Për më tepër, Qeveria kroate kishte miratuar dokumente të ndryshme strategjike që synonin parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe kishte ngritur ekipe të specializuara posaçërisht të ngarkuara me dhënien e asistencës për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore. Gjykata ishte e bindur që në momentin që ishte kryer dhe ndjekur penalisht vepra penale e pretenduar, në Kroaci ka patur një kuadër të përshtatshëm ligjor për shqyrtimin e saj në kontekstin e trafikimit të qenieve njerëzore, prostitucionit të detyruar dhe shfrytëzimit të prostitucionit.

(ii) Mbështetja e dhënë kërkueses - Kërkuesja nuk kishte kundërshtuar apo bërë ankim në lidhje me sjelljen e autoriteteve të brendshme, duke përfshirë gjykatën që zhvilloi gjykimin në ngarkim të T.M., ose një autoriteti tjetër, apo ndonjë ankim tjetër në lidhje me të drejtat e saj si viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore, ose në lidhje me asistencën, mbështetjen dhe çdo formë tjetër të këshillimit të dhënë asaj ose mungesës së tij. Gjatë gjyimit kërkuesja ishte informuar në lidhje me mundësinë e kontaktit të Departamentit për Organizimin dhe Dhënien e Mbështetjes për Dëshmitarët dhe Viktimat brenda gjykatës penale. Nuk kishte prova që kërkuesja e kishte kontaktuar këtë Departament. Në këto rrethana, Gjykata pranoi që kërkueses i ishte dhënë vërtet mbështetje dhe asistencë siç jepet nga Qeveria. Kjo përfshinte fillimisht njohjen e statusit të saj si viktimë e

trafikimit të qenieve njerëzore. Kështu, asaj i ishte dhënë këshillim nga Kryqi i Kuq Kroat dhe ndihmë ligjore falas nëpërmjet programit të financuar nga Shteti të realizuar nga një organizatë jo-qeveritare. Për më tepër, menjëherë pas kërkesës së kërkueses, i akuzuari ishte larguar nga salla e gjyqit dhe kërkuesja i kishte dhënë provat në mungesë të tij.

(iii) Nëse autoritetet shtetërore i përmbushën detyrimet e tyre procedurale - Policia dhe autoritetet e ndjekjes penale kishin vepruar shpejt, posaçërisht në lidhje me kryerjen e kontroleve në mjediset e T.M.-së, duke intervistuar kërkuesen dhe akuzuar T.M.-në. Nga ana tjetër, të vetmit dëshmitarë të intervistuar gjatë hetimit dhe dëgjuar në gjyq ishin kërkuesja dhe shoqja e saj. Ndërsa është e vërtetë që shoqja e saj nuk e kishte mbështetur tërësisht deklarin e kërkueses, ka patur tregues që ishte nëna e shoqes së saj dhe jo vetë shoqja ajo që kërkuesja iu drejtua për ndihmë dhe me të cilën ajo kishte folur në telefon në ditën që ishte arratisur. Menjëherë pasi ishte larguar nga T.M.-ja, kërkuesja kishte kaluar disa muaj me shoqen e saj dhe nënën e kësaj të fundit. Megjithatë, autoritetet hetimore nuk kishin marrë ndonjë deklarin nga nëna. Po ashtu, ato nuk kishin intervistuar shokun e shoqes së saj, i cili e kishte sjellë atë tek apartamenti i shoqes së saj. këto elemente tregojnë që autoritetet nuk kishin bërë përpjekje serioze për të hetuar thellësisht të gjitha rrethanat përkatëse dhe të mbledhnin provat e disponueshme. Ato nuk kishin bërë përpjekje të mëtejshme për të identifikuar klientët e kërkueses dhe ti intervistonin ata. Ato gjithashtu nuk kishin marrë prova nga nëna e kërkueses, pronari i shtëpisë dhe fqinjët e kërkueses dhe T.M.-së, ku të gjithë këta mund të kishin njohuri përkatëse në lidhje me marrëdhënien ndërmjet kërkueses dhe T.M.-së, rrahjet e pretenduara dhe kycjen e saj në apartament.

Nuk kishte asnjë tregues që autoritetet e brendshme kishin bërë përpjekje serioze për të hetuar hollësisht rrethanat e mëposhtme, që ishin të rëndësishme për të vlerësuar nëse T.M.-ja e kishte detyruar kërkuesen në prostitucion: pretendimet e kërkueses që varej ekonomikisht nga T.M.-ja dhe të formave të ndryshme të detyrimit që ai mendohet të ketë përdorur ndaj saj, si theksimi që ka qenë një ish-police dhe kishte një 'arsenal me armë', duke bërë kërcënime për të dëmtuar familjen e saj dhe manipuluar atë me

premtime boshe që ai do ti gjente asaj një ‘punë të rregullt’, si dhe deklarimi i shoqes së saj që kërkuesja ishte shumë e stresuar dhe e trembur nga T.M.-ja i cili kishte vazhduar ta kërcënonte atë nëpërmjet rrjetit të medias sociale pasi ajo ishte arratisur. Duket se nuk i ishte kushtuar asnjë konsideratë faktit që gjatë kontrollit të mjediseve të T.M.-së, policia kishte gjetur disa armë automatike. Gjykatat e brendshme nuk i kishin kushtuar vëmendjen e duhur këtyre elementëve dhe kishin nxjerrë përfundimin që kërkuesja i kishte ofruar shërbimet seksuale vullnetarisht. Për më tepër, sipas ligjit kroat, Konventës për Shtypjen e Trafikut të Personave dhe Shfrytëzimit të Prostitucionit të të Tjerëve dhe Konventës së Këshillit të Europës Kundër Trafikimit, pëlqimi i viktimës nuk është i rëndësishëm. Përveç kësaj, gjykatat e brendshme e kishin refuzuar deklarimin e kërkueses si të pabesueshme dhe jo-koherente, duke ditur që ajo ishte e pasigurt, me pauza dhe hezituese në të folurën e saj. Autoritetet e brendshme nuk kishin bërë asnjë vlerësim në lidhje me ndikimin e mundshëm të traumës psikologjike mbi aftësinë e kërkueses për të folur në mënyrë të njëtrajtshme dhe të qartë mbi rrethanat e shfrytëzimit të saj. Duke ditur vulnerabilitetin e viktimës së veprave penale seksuale, përballja me T.M.-në në sallën e gjyqit mund të kishte një ndikim negativ mbi kërkuesen, megjithëse T.M.-ja u largua në vijim nga salla e gjyqit.

Në tërësi, autoritetet përkatëse shtetërore nuk i kishin përmbushur detyrimet e tyre procedurale sipas Nenit 4.

**Përfundim:** shkelje (gjashtë vota me një).

Neni 41: 5 000 Euro në lidhje me dëmin jo-financiar.

## **NENI 5**

### **Neni 5 § 5:**

***Vasilevskiy dhe/et Bogdanov – Rusi, 52241/14 dhe/et 74222/14***, Vendim themeli 10.7.2018

Kompensimi/Réparation Moskompensimi i duhur i personave që i janë nënshtruar burgimit të padrejtë në vend

**Fakte** - Kërkuesi u ankuan që masa e kompensimit të dhënë nga gjykata e brendshme për burgimin e tyre të padrejtë ishte kaq e vogël sa që cenohen vetë thelbi i së drejtës sipas Neni 5 § 5 të Konventës.

**Ligji** – Neni 5 § 5: Gjykatat e brendshme kishin vendosur në themel që Z Vasilevskiy i ishte hequr liria për një vit e gjysmë si rezultat i parregullsisë së madhe dhe të dukshme dhe fajësimi i paligjshëm i Z Bogdanov ishte si pasojë e mohimit flagrant të drejtësisë duke minuar kështu ligjshmërinë e ndalimit pasues. Kështu, Neni 5 § 5 ishte i zbatueshëm.

Gjykatat e brendshme ishin përpjekur, në mirëbesim dhe me sa e kishin të mundur, të vlerësonin nivelin e vuajtjes, depresionit, ankthit dhe efekteve të dëmshme të kaluar nga kërkuesit për shkak të burgimit të tyre të paligjshëm. Një vlerësim i tillë duhet të kryhet në mënyrë të tillë që të jetë në pajtim me kërkesat ligjore të brendshme dhe të marrë parasysh standardin e jetesës në vendin përkatës, edhe nëse kjo sjell si pasojë dhënien e shumave që ishin më të ulëta se ato të dhëna nga Gjykata në raste të ngjashme. Z Vasilevskiy i ishin dhënë 3 320 Euro për 47 ditë gjatë të cilave ai ishte i ndaluar në mënyrë të paligjshme dhe Z Bogdanov 324 Euro për 119 ditë gjatë të cilave ai ishte i ndaluar në mënyrë të paligjshme, të cilat rridhnin nga normat përkatëse prej 7 Euro dhe 2.70 Euro në ditë për heqjen e paligjshme të lirisë. Niveli i kompensimit nuk ishte thjesht tepër më e ulët nga sa jepte Gjykata në raste të ngjashme, por edhe jo-proporcionale në krahasim me ndalimin e tyre dhe neglizhuese në terma absolute. Shumat e dhëna ishin kaq të ulëta sa ato cenonin thelbin e të drejtave të realizueshme të kërkuesve për kompensim.

**Përfundim:** shkelje (njëzëri)

Neni 41: 5,000 EUR secili në lidhje me dëmin jo-financiar. Përveç kësaj, forma më e përshtatshme e vënies në vend do të ishte në parim, rihapja e gjykimit të kompensimit, nëse kërkohet, dhe një vlerësim i ri i pretendimit të kërkuesve, në pajtim me kërkesat e kësaj dispozite dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës. Kjo ishte një mundësi ligjore brenda vendit.

## **NENI 6**

### **Gjykim penal**

#### **Neni 6-1:**

***Kontalexis kundër Greqisë (nr. 2) - 29321/13***, Vendim themeli 6.9.2018  
(Seksioni I)

#### **Aksesi në gjykatë**

#### **Akuza penale**

#### **Gjykimi i drejtë**

Ankimi në lidhje me refuzimin nga gjykatat e brendshme për të rihapur gjykimin penale në vijim të një shkeljeje të Nenit 6 të Gjykatës Europiane: e pranueshme

Refuzimi nga Gjykata e Kasacionit të kërkesës për rishikimin e një vendimi penal në vijim të një vendimi të Gjykatës Europiane që konstaton shkelje të Nenit 6: Nuk ka shkelje

**Fakte** - Më 31 maj 2011, Gjykata Europiane konstatoi një shkelje të Nenit 6 § 1 në çështjen *Kontalexis kundër Greqisë*, 59000/08, të bërë nga i njëjti kërkuar. Më 18 janar 2013, Gjykata e Kasacionit refuzoi një kërkesë nga kërkuar për rihapjen e gjykimit mbi bazën e Nenit 525 § 1 e) e Kodit të Procedurës Penale.

Në mbështetje të Nenit 6 § 1 të Konventës, kërkuar pretendoi që refuzimi nga gjykatat e brendshme i rihapjes së gjykimit në lidhje me të përbënte një shkelje tjetër të së drejtës së tij për një gjykim të drejtë nga një gjykatë e krijuar me ligj.

**Ligji** – Neni 6, § 1

*a) Pranueshmëria*

*i. A përjashtonte Neni 46 i Konventës shqyrtimin nga ana e Gjykatës të ankesës së re në pajtim me Nenin 6 të Konventës?* - Kërkesa e re përmbante një ankim të ri në lidhje me padrejtësinë e pretenduar të procedurës për shqyrtimin e ankimit të posaçëm të kërkuar, kundërvënë kjo me rezultatin

si të tillë dhe ndikimin e tij mbi ekzekutimin e duhur të vendimit të Gjykatës së datës 31 maj 2011. Një procedurë mbikëqyrjeje në lidhje me ekzekutimin e vendimit është tashmë në shqyrtim e sipër nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës. Kjo, megjithatë, nuk e pengon Gjykatën në shqyrtimin e një kërkesë të re në masën që ajo përfshin aspekte të reja që nuk ishin përcaktuar në vendimin e parë. Kështu, Neni 46 nuk e përjashton shqyrtimin nga ana e Gjykatës së ankimit të ri të kërkuarit në lidhje me drejtësinë e gjykimit që kulmon me vendimin e Gjykatës së Kasacionit.

ii. *A ishte ankesa e re ratione materiae në përputhje me nenin 6 të Konventës?* - Procedura sipas Kodit të Procedurës Penale nuk përbënte ndonjë procedurë të jashtëzakonshme që dilte jashtë sferës së Nenit 6, ku ai u mbyll me një vendim të gjykatës kompetente duke refuzuar rihapjen e gjykimit penal. Shqyrtimi ishte përqendruar në përcaktimin e një akuze penale në ngarkim të kërkuarit brenda kuptimit të Nenit 6, § 1, të Konventës. Për pasojë, gjykimi para Gjykatës së Kasacionit merr mbrojtjen e Nenit 6 § 1.

iii. *A mund të pretendojë kërkuari të jetë një viktimë e shkeljes së Nenit 6 në gjykimin e brendshëm për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës?* - Kundërshtimi paraprak i Qeverisë në lidhje me statusin e viktimës së kërkuarit kishte të bënte me gjykimet që kulmojnë me vendimin e Gjykatës së datës 31 maj 2011. Ai kishte të bënte me një situatë para gjykimit për sa i takon kërkesës së kërkuarit për rihapjen e çështjes. Vetëm drejtësia e gjykimit në vijim të kërkesës së kërkuarit për rihapjen e çështjes mund të jetë objekt i një rishikimi të ri. Kështu kundërshtimi rrëzohet.

b) Themeli - Në momentin e refuzimit të urdhërimit të rihapjes së gjykimit, Gjykata e Kasacionit ishte e mendimit që shkelja e konstatuar nga Gjykata ishte e një natyre formale dhe nuk kishte të bënte me të drejtën e garantuar nga Neni 6, që është e drejta e të akuzuarit për tu gjykuar nga një tribunal i pavarur dhe i paanshëm dhe nga gjyqtarë të pavarur dhe të paanshëm.

Në mënyrë më specifike, Gjykata e Kasacionit ishte e mendimit që shkelja e konstatuar nga Gjykata nuk kishte të bënte me drejtësinë e gjykimit dhe nuk kishte një ndikim negativ mbi vlerësimin e bërë nga gjyqtarët e gjykatës penale. Shkelja ishte një *fait accompli* dhe ishte e mbuluar nga efekti *res judicata* i vendimit të Gjykatës së Kasacionit duke rrëzuar shkakun e ankimit

që Gjykata në vijim e kishte lënë në fuqi. Shkaku i ankimit në lidhje me përbërjen e pretenduar të paligjshme të gjykatës ishte rrëzuar nga Gjykata e Kasacionit në gjykimin e parë dhe që vendimi nuk mund të kundërshtohet në mënyrë prapavepruese në vijim të vendimit të Gjykatës.

Në pajtim me interpretimin nga Gjykata e Kasacionit të Kodit të Procedurës Penale, parregullsitë procedurale të tipit të konstatuar në këtë çështje nuk shërbenin automatikisht si shkak për të drejtën e rihapjes së gjykimit. Ky interpretim, i cili kishte efektin e kufizimit të situatave që mund të bëhen shkak për rihapjen e gjykimeve penale të cilat ishin përmbyllur me efekt përfundimtar, ose të paktën nënshtrimin e tyre kritereve që vlerësohen nga gjykatat e brendshme, nuk dukej si arbitrar. Për më tepër, kjo mbështetej nga praktika e konsoliduar e Gjykatës.

Gjykata e Kasacionit ishte e mendimit të vendimi i gjykatës i vitit 2011 nuk kishte hedhur dyshim mbi pavarësinë ose paanësinë e trupit gjykues që kishte dhënë vendimin në fjalë ose mbi drejtësinë e gjykimit si një i tërë.

Duke patur parasysh marzhin e vlerësimit që u rezervohet autoriteteve të brendshme në interpretimin e vendimeve të Gjykatës dhe duke patur parasysh parimet që rregullojnë ekzekutimin e vendimeve, Gjykata e konsideroi të panevojshme të shprehte një mendim mbi vlefshmërinë e interpretimit të Gjykatës së Kasacionit në vendimin e saj të datës 18 janar 2013. Në fakt ishte e mjaftueshme për Gjykatën të bindej që ai vendim nuk ishte arbitrar, që do të thotë që gjyqtarët e Gjykatës së Kasacionit nuk kishin shtrembëruar ose keqpërfaqësuar vendimin e themelit të dhënë nga Gjykata.

Edhe nëse ajo nuk binte dakord në çdo aspekt me analizën që gjendet në vendimin e datës 18 janar 2013, Gjykata nuk mund të nxjerrë përfundimin që leximi i vendimit të Gjykatës së vitit 2011 nga Gjykata e Kasacionit, i parë si një i tërë, ishte rezultat i një gabimi të dukshëm ligjor ose faktik që sillte ‘mohimin e drejtësisë’ dhe në këtë mënyrë një vlerësim të vesuar nga arbitrariteti.

**Përfundim:** nuk ka shkelje (njëzëri)

## NENI 6

### Neni 6 § 3(d)

#### Dëgjimi i dëshmitarëve

**N.K. – Gjermani/Allemagne, 59549/12**, Vendim themeli 26.7.2018 (Seksioni V)

Fajësimi për dhunë në familje bazuar në prova të forta mbështetëse të patestuara të viktimës që refuzon të dëshmojë, që është raportuar nga gjyqtari hetimor: nuk ka shkelje

**Fakte** - Procedimi filloi në ngarkim të kërkuesit bazuar në dyshimin që ai kishte kryer akte dhune ndaj bashkëshortes së tij, R.K. Ajo u dëgjua me kërkesë të zyrës së prokurorit publik nga gjyqtari hetimor, pasi ky i fundit kishte vendosur ta përjashtonte kërkuesin nga seanca në bazë të Kodit të Procedurës Penale, pasi kishte rrezik që, duke ditur natyrën e veprave penale të raportuara, R.K.-ja nuk do të dëshmonte ose nuk do të tregonte të vërtetën në praninë e kërkuesit. Kërkuesi nuk kishte caktuar mbrojtjes për të marrë në pyetje të dyfishtë R.K.-në në këtë seance siç e kërkonte procedura. U hap seanca kryesore kundër kërkuesit dhe R.K.-ja njoftoi gjykatat e brendshme që ajo nuk dëshironte të jepte prova. E drejta e bashkëshortit/es - të tashëm apo të shkuar - për të mos dhënë prova ishte e parashikuar në Kodin e Procedurës Penale, por praktika gjyqësore parashikonte një përjashtim për një 'thënie spontane' të bërë nga dëshmitari para ose jashtë dëshmisë së tij ose të saj formale. Gjyqtari hetimor u dëgjua në lidhje me provat që ai kishte marrë nga marrja në pyetje e R.K.-së, ashtu siç u morën edhe punonjësit e policisë të pranishëm në vendin e ngjarjes dhe deklaratimet e bëra nga R.K.-ja u kualifikuan si 'thënie spontane' dhe u përdorën nga gjykata e brendshme. Në vijim R.K.-ja deklaroi që ajo nuk jepte pëlqimin për përdorimin e provave që ajo i kishte dhënë gjyqtarit hetimor, punonjësve të policisë dhe ekspertit mjekësor të caktuar nga gjykata; dhe as nuk ra dakord me përdorimin e rezultateve të vizitës mjekësore. Gjykata e brendshme e dënoi kërkuesin për sulm të rrezikshëm, shtrëngim dhe shkaktim të dëmtimeve trupore me dashje. Ai u dënua me gjashtë vjet dhe gjashtë muaj burg. Të gjitha ankimet u rrëzuan.



**Ligji** – Neni 6 § 3 (d): U zbatuan, *mutatis mutandis*, parimet e parashikuara në çështjet Al-Khawaja dhe Tahery dhe nën Schatschaschwili në lidhje me dëshmitarët në mungesë edhe në këtë skenar. R.K.-ja kishte të drejtë sipas Kodit të Procedurës Penale të refuzonte dhënien e provave në ngarkim të kërkuesit për shkak se ajo ishte e martuar me të. Në këtë mënyrë, ishte në shkak i rëndësishëm që ajo të mos paraqitej për marrje të dyfishtë në pyetje në gjykim dhe për pranimin e provave të R.K.-së siç u raportuan nga gjyqtari hetimor dhe, pjesërisht, nga dy punonjësit e policisë në gjyq. Në këtë aspekt, Gjykata nuk dalloi ndonjë arbitraritet në kualifikimin e deklarimit të R.K.-së nga gjykata e brendshme dhënë policisë si një ‘thënie spontane’ dhe ishte e mendimit që nuk dukej se të drejtat e kërkuesit sipas Konventës ishin shpërfillur duke pranuar këtë deklaram, siç u raportua nga punonjësit e policisë, si provë.

Në lidhje me rëndësinë e provave të patestuara, deklaramet paragjykimore të R.K.-së nuk ishin e vetmja provë mbi të cilën u mbështet gjykata. Kjo gjykatë ishte mbështetur edhe në deklarimet e këshilltarit të strehës së grave të cilit R.K.-ja i kishte dhënë një informacion të hollësishëm në lidhje me incidentet dhe i kishte treguar dëmtimet e saj; djalën e R.K.-së, i cili kishte dëgjuar ulërime dhe që kërkuesi dhe R.K.-ja ishin duke u zënë; deklarimet e disa fqinjëve që e kishin parë R.K.-në menjëherë pas largimit të banesës martesore me një plagë në kokë që i rridhte gjak në një gjendje të tmerruar dhe ishin parë që kërkuesi të dilte nga shtëpia dhe të ndiqte atë me makinë; letrën e R.K.-së në të cilën ajo kishte dhënë shembuj të veprimeve të kryera nga kërkuesi gjatë periudhës në fjalë; një letër të përgatitur që atë e kishte detyruar ta shkruante bashkëshorti për gruan e një të dashuri të saj të mëparshëm; dhe deklarimin e R.K.-së për punonjësit e policisë, që gjykata i kishte kualifikuar si ‘thënie spontane’. Gjykata e brendshme kishte nxjerrë përfundimin që dënimi i kërkuesit mund të bazohet në deklarimet e R.K.-së, siç ishin raportuar nga gjyqtari hetimor, pasi ato ishin mbështetur nga faktorë të tjerë të konsiderueshëm të pavarur prej tyre. Ky vlerësim i peshës së provave kishte qenë as i papranueshëm dhe as arbitrar. Në të njëjtën kohë, deklarimi i R.K.-së i bërë në fazën paragjykimore kishte të paktën peshë të konsiderueshme për dënimin e kërkuesit dhe pranimi i tij mund të kishte vesuar mbrojtjen.

Në lidhje me masat balancuese për të kompensuar veset e mbrojtjes si rezultat i pranimit të provave të patestuara me dëshmitarë në gjykim, Qeveria - dhe vetë gjykata e brendshme - kishte rënë dakord që mund të ishte caktuar një avokat për llogari të kërkuarit të merrte në pyetje R.K.-në gjatë seancës para gjyqtarit hetimor. Duke mos e bërë këtë, autoritetet kishin marrë përsipër një risk të parashikuar, duke ditur që R.K.-ja ishte e martuar me kërkuarin dhe në këtë mënyrë kishte të drejtë të refuzonte dëshminë në pajtim me ligjin e brendshëm - një eventualitet që në vijim ishte materializuar - që as kërkuari dhe as avokati i tij nuk do të ishte në gjendje për të pyetur R.K.-në në ndonjë fazë të gjyqimit. Megjithatë, gjykata e brendshme kishte vlerësuar tërësisht dhe me kujdes besueshmërinë e R.K.-së dhe besueshmëria e deklarimeve të saj siç u raportua nga gjyqtari hetimor, si dhe kishte prova të mjaftueshme dhe të forta përforcuese. Kërkuarit i ishte dhënë mundësia të paraqiste versionin e tij të ngjarjeve, që ai kishte zgjedhur për të mos e bërë dhe të marrë në pyetje të dyfishtë gjyqtarin hetimor kur ky i fundit kishte dhënë prova si dëshmitar. Në bërjen e një vlerësimi të drejtësisë së gjyqimit në tërësi, Gjykata, duke patur parasysh konsideratat e mësipërme - veçanërisht peshën e deklaramit të R.K.-së për dënimin e kërkuarit, qëndrimin e gjykatës së brendshme për vlerësimin e këtij deklarimi, disponibilitetin dhe fuqinë e provave të mëtejshme inkriminuese dhe masat procedurale kompensuese të marra nga gjykata e brendshme -, konstatoi që faktorët balancues ishin në gjendje për kompensimin e veseve nën të cilat kishte punuar mbrojtja. Procedimi penal në ngarkim të kërkuarit, i parë në tërësinë e tij, nuk ishte bërë i padrejtë nëpërmjet pranimit si provë të deklaramit të dëshmitarit të patestuar R.K., siç u raportua nga gjyqtari hetimor.

**Përfundim:** nuk ka shkelje (njëzëri)

## NENI 7

### Neni 7-1

#### Nulla poena sine lege

***G.I.E.M. S.r.l. dhe të Tjerë kundër Italisë (GC) - 1828/06, 34163/07 dhe 19029/11, Vendim themeli 28.6.2018 (GC)***

Konfiskimi i detyrueshëm i tokës ‘së zhvilluar në mënyrë të paligjshme’, pavarësisht nga çdo përgjegjësi penale: shkelje, nuk ka shkelje

Neni 1 i Protokollit nr. 1

Neni 1, par 1 i Protokollit nr. 1

Gëzimi paqësisht i sendeve në zotërim

Konfiskimi i detyrueshëm i tokës ‘së zhvilluar në mënyrë të paligjshme’, pavarësisht nga çdo përgjegjësi penale: shkelje

**Fakte** - Kërkuesit janë tre shoqëri me personalitet juridik dhe një drejtor i shoqërisë së katërt (Z Gironda).

Në bazë të ligjit italian të planifikimit, nëse konstatohet thelbësisht vepra penale e ‘zhvillimit të paligjshëm të truallit’, gjykata penale është e detyruar, pavarësisht nëse të pandehurit dënohen, të konfiskojë tokën e zhvilluar (dhe çdo ndërtesë mbi të), edhe nëse kjo është në zotërim të një pale të tretë (përveç rastit kur pretendohet të jetë vepruar në mirëbesim).

Kërkuesit u ankuan që ata ishin prekur nga masat e konfiskimit pa qenë formalisht të dënuar (dhe as shoqëria dhe as drejtorët e saj nuk ishin ndjekur penalisht; ose për shkak se vetëm drejtorët ishin ndjekur penalisht; ose për shkak se procedimi penal ishte parashkruar - ku ky është rasti i Z Gironda).

**Ligji** - Neni 7 i Konventës

(a) Zbatueshmëria - Një rishikim i çështjes nën dritën e kritereve të mëposhtme bëri që Dhoma e Madhe të konfirmojë përfundimin e arritur nga Dhoma në çështjen Sud Fondi srl dhe të Tjerë kundër Italisë (dec.) (75909/01, 30 gusht 2007, Shënimi Informativ 100): meqenëse masat e konfiskimit mund të konsideroheshin si ‘penalitete’ në kuptimin e Nenit

të Konventës, ky Nen ishte i zbatueshëm, edhe në mungesë të procedimit penal për qëllimet e Nenit 6.

Ky përfundim nuk përjashtoi mundësinë e autoriteteve të brendshme për të vendosur ‘penalitet’ (brenda kuptimit autonom të atij koncepti) nëpërmjet procedurave të ndryshme nga ato të klasifikuara si ‘penale’ sipas ligjit të brendshëm.

(i) A ishin vendosur konfiskimet pas dhënies së fajësisë për veprat penale? - Megjithëse më parë nuk ishte dhënë asnjë dënim penal në ngarkim të shoqërive kërkuese ose përfaqësuesve të tyre, masa e kundërshtuar e konfiskimit ishte megjithatë e lidhur me një ‘vepër penale’ bazuar në dispozitat penale të përgjithshme. Sidoqoftë, një përfundim i ndryshëm në lidhje me këtë kriter në vetvete nuk do të ishte përfundimtar.

(ii) Kualifikimi i konfiskimit në ligjin e brendshëm - Neni 44 i Kodit të Ndërtimit, që rregullon masat e konfiskimit në fjalë në këtë çështje, kishte titullimin ‘Sanksione penale’.

(iii) Natyra dhe qëllimi i masës së konfiskimit - Natyra dhe qëllimi i konfiskimit të pronës së kërkuësve ishin ndëshkimore, pasi masa e konfiskimit ishte një sanksion detyrues, që nuk i nënshtrohej verifikimit të dëmit faktik ose një rreziku specifik për mjedisin, dhe në këtë mënyrë mund të aplikohet edhe në mungesë të një aktiviteti faktik për transformimin e tokës.

(iv) Ashpërsia e efekteve të konfiskimit - Masa e kundërshtuar e konfiskimit ishte një sanksion tepër i ashpër dhe ndërhyrës. Brenda kufijve të truallit përkatës, ajo ndërhynte jo vetëm tek trualli mbi të cilin ishte ndërtuar (ose ku synohej të ndëртоhej) ose në lidhje me të cilin ishte konstatuar një ndryshim i ndaluar i përdorimit, por edhe tek të gjitha parcelat e tokës që përbënin truallin. Për më tepër nuk mund të kërkohej kompensim.

(v) Procedurat e adoptimit dhe zbatimit të masave të konfiskimit - Masa ishte urdhëruar nga gjykatat penale. Gjykata nuk ishte e bindur nga argumenti që gjykatat penale kishin vepruar ‘në vend të një autoriteti administrativ’. Roli i gjykatës penale nuk ishte thjesht verifikimi që të mos ishte kryer asnjë zhvillim truall në mungesë ose në shkelje të një leje planifikimi, por gjithashtu të siguronte që zhvillimi, qoftë i autorizuar apo jo, të ishte në

përputhshmëri me të gjitha rregullat e tjera të zbatueshme (rregullimet planifikuese). Me fjalë të tjera, gjykatat penale vepronin në mënyrë të pavarur nga autoriteti administrativ, pozicionin e të cilit ato mund të mos e merrnin parasysh.

(Shih gjithashtu Varvara kundër Italisë, 17475/09, 29 tetor 2013, Shënim Informativ 167)

(b) Përputhshmëria me garancitë e Nenit 7

(i) Nëse masat e kundërshtuara të konfiskimit kërkonin një element mendor - Dhoma e Madhe konfirmoi që Neni 7, për qëllimet e ndëshkimit, kërkon një lidhje mendore që të demonstrojë një element të përgjegjësisë personale nga ana e autorit të veprës penale, pa të cilën ndëshkimi nuk mund të konsiderohet si i parashikueshëm.

Megjithatë, kjo kërkesë nuk e përjashton ekzistencën e formave të caktuara të përgjegjësisë objektive që rrjedh nga prezumimet e përgjegjësisë. Në parim, Shtetet Kontraktuese mbeten të lira për të penalizuar një fakt të thjeshtë ose objektiv si të tillë, pavarësisht nëse ai ka rrjedhur nga synimi kriminal apo nga neglizhenca. Prezumimet e faktit ose të ligjit do të ishin të pranueshme, me kusht që ato të mos kenë efektin e bërjes së pamundur për një individ të çlirohet nga akuzat në ngarkim të tij. Meqenëse Konventa duhet të lexohet si një e tërë, parimet e praktikës gjyqësore sipas Nenit 6 par 2 duhej të zbatoheshin edhe sipas Nenit 7.

(ii) Mungesa e një 'fajësimi' formal - Neni 7 përjashtonte caktimin e një sanksioni penal për një individ për sa kohë nuk është konstatuar dhe deklaruar paraprakisht përgjegjësia penale personale. Përndryshe do të shkelej parimi i prezumimit të pafajësisë i garantuar nga Neni 6, par 2 i Konventës.

Gjykata, duke theksuar që të gjitha vendimet e saj kishin të njëjtën vlerë ligjore (pasi natyra e tyre detyruese dhe autoriteti interpretues nuk varej nga struktura nga e cila ishin dhënë), deklaroi që vendimi Varvara nuk sillte në përfundimin që masat e konfiskimit për zhvillim të paligjshëm të truallit duhej të shoqëroheshin me dhënie fajësie të vendosura nga gjykatat 'penale' brenda kuptimit të ligjit të brendshëm. Zbatueshmëria e Nenit 7

nuk kishte efektin e ‘kriminalizimit’ nga ana e Shteteve të procedurave që, në ushtrim të diskrecionit të tyre, ata nuk i kishin klasifikuar sikur futeshin rigorozisht në sferën e ligjit penal. Ishte e nevojshme dhe e mjaftueshme për deklarimin e përgjegjësisë penale që të respektoheshin garancitë e parashikuara në Nenin 7, me kusht që ajo të rridhte nga procedimet në pajtim me Nenin 6.

Gjykata megjithatë duhej të konstatonte nëse masat e kundërshtuara konfiskuese të paktën kërkonin një deklaram formal të përgjegjësisë penale në lidhje me kërkuesit. Meqenëse shoqëritë kërkuese nuk ishin ndjekur penalisht vetë, çështja nëse deklarimi i përgjegjësisë penale i kërkuar nga Neni 7 duhej të përmbushte kërkesat formale dilte vetëm në lidhje me Z Gironda.

Ishte e nevojshme që fillimisht në një shoqëri demokratike të merret parasysh rëndësia e respektimit të shtetit të së drejtës dhe besimit publik në sistemin e drejtësisë, dhe së dyti, objekti dhe qëllimi i rregullave të zbatuara nga gjykatat italiane. Rregullat përkatëse synonin të shmangnin padënueshmërinë që do të rridhte nga një situatë ku, nëpërmjet efektit të kombinuar të veprave penale komplekse dhe afateve relativisht të shkurtra të parashkrimit, autorët e këtyre veprave e shmangën sistematikisht ndjekjen penale dhe, mbi të gjitha, pasojat e sjelljes së tyre të papërshtatshme.

Sipas mendimit të Gjykatës, nëse gjykatat konstatuan që qëndronin të gjithë elementët e veprës penale të zhvillimit të paligjshëm të trullit (si në çështjen e Z Gironda), ndërsa gjykimi u ndërpre thjesht për shkak të parashkrimit - dhe me kusht që të jenë respektuar të drejtat e mbrojtjes -, këto konstatime mund të konsideroheshin sikur në thelb përbënin ‘fajësimin’ e kërkuar nga neni për vendosjen e në penalteti.

(iii) Nëse masat konfiskuese mund të vendoseshin mbi shoqëritë kërkuese, që nuk ishin palë në gjykim - Duke patur parasysh parimin që një person nuk mund të dënohet për një veprim që përfshin përgjegjësinë penale të një tjetri, masa e konfiskimit që u aplikua, si në rastin në fjalë, për individët ose subjektet juridike që nuk ishin palë në gjykim ishte në papajtueshmëri me Nenin 7 të Konventës.

Meqenëse ligji italian që ishte në fuqi në atë moment nuk parashikonte përgjegjësinë e subjekteve juridike, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, si të tilla, nuk mund të jenë ‘palë’ në procedimet penale, pavarësisht personalitetit të tyre juridik. Për pasojë, ato nuk mund të ‘përfaqësoheshin’ juridikisht në kontekstin e procedimeve përkatëse penale në çështjen në fjalë. Në këtë mënyrë shoqëritë mbetën ‘Palë të treta’ në lidhje me këto procedime. Megjithatë, veprimet (dhe përgjegjësia pasuese) e përfaqësuesve të tyre përkatës ligjorë u atribuoheshin drejtpërdrejt këtyre shoqërive.

Përfundime: shkelje në lidhje me shoqëritë kërkuese (pesëmbëdhjetë vota me dy); nuk ka shkelje në lidhje me Z Gironda (dhjetë vota me shtatë).

Neni 1 i Protokollit nr. 1: Ankesa u shqyrtua në pajtim me paragrafin e dytë të kësaj dispozite.

Në lidhje me qëllimin e ndjekur, shqyrtimi i çështjes së tashme të pronës së konfiskuar e bënte të dyshimtë që konfiskimi kishte kontribuar automatikisht në mbrojtjen e mjedisit.

Çdo ndërhyrje në gëzimin paqësisht të mjeteve të veta në zotërim duhet të marrë parasysh sa më poshtë:

(i) Duhet të jetë proporcionale, siç vlerësohet nën dritën e një numri faktorësh: mundësia e masave alternative më pak kufizuese, si prishja e strukturave që ishin në papajtueshmëri me rregulloret përkatëse ose anulimi i planeve të zhvillimit; natyra e kufizuar ose e pakufizuar e sanksionit (në varësi nëse ai prekte tokën e zhvilluar dhe të pazhvilluar, dhe sferat që u përkasin palëve të treta); dhe shkallën e fajësisë ose neglizhencës nga ana e kërkuesve (ose raportit ndërmjet sjelljes së tyre dhe veprës penale në fjalë).

(ii) Garancitë procedurale, që i ofrojnë individit një mundësi të arsyeshme për tu shprehur në lidhje me çështjen dhe për të diskutuar çështjet përkatëse në gjykime mbi bazë kontradiktoriteti që përputhen me parimin e barazisë së armëve.

Aplikimi automatikisht i masës së kundërshtuar të konfiskimit - përveç se në lidhje me palët e treta në mirëbesim - ishte qartazi në papajtueshmëri me këta parime:

(i) ai nuk i lejonte gjykatat të konstatonin cilat instrumente ishin me të përshtatshmit në lidhje me rrethanat specifike të çështjes ose, në përgjithësi, për të peshuar synimet legjitime përkundrejt të drejtave të atyre që prekeshin nga sanksioni; dhe

(ii) meqenëse shoqëritë kërkuese nuk ishin palë në gjykimet përkatëse, asnjë prej garancive procedurale të përmendura më sipër nuk ishte i zbatueshëm për to.

**Përfundim:** shkelje në lidhje me të gjithë kërkuesit (njëzëri).

Neni 6, par 2, i Konventës (Z Gironda): Kërkuesi ishte deklaruar fajtor në themel pavarësisht faktit që ndjekja penale veprës në fjalë ishte parashkuar; kjo përbente një shkelje të së drejtës së tij për tu prezumuar i pafajshëm.

**Përfundim:** shkelje në lidhje me Z Gironda (gjashtëmbëdhjetë vota me një).

Neni 41: nën rezervë.

## NENI 8

### Neni 8-1

#### Respektimi i jetës familjare

**Jansen kundër Norvegjisë - 2822/16**, Vendim themeli 6.9.2018 (Seksioni V)

Nënës i refuzohet e drejta e vizitës në lidhje me fëmijën e saj në qendrën e kujdesit për shkak të rrezikut të rrëmbimit: *shkelje*

**Fakte** - Në vitin 2011, kur lindi e bija e saj, kërkuesja ishte 19 vjeç dhe banonte në shtëpi me prindërit e saj, Romë norvegjezë. Menjëherë pas kësaj, ajo dhe e bija e saj u hodh në rrugë nga i ati i kërkueses dhe ato u transferuan në një qendër për kujdesin familjar - një institucion i prindërve me fëmijë. Ato lëvizën ndërmjet banesës së kërkueses dhe qendrës së kujdesit familjar disa herë. Gjatë një qëndrimi në qendrën e kujdesit familjar, gjyshi qëlloi me thikë një çift fqinj, të cilët, sipas tij, kishin ndihmuar kërkuesen të transferohej në qendrën e kujdesit familjar. Pas këtij incidenti kërkuesja u kthye përsëri



në shtëpi. Menjëherë pas kësaj, Shërbimi për Mirëqenien e Fëmijës bëri kërkesë për një urdhër mbrojtjeje në pajim me ligjin e brendshëm.

Në qershor 2012, e bija e kërkueses u transferua tek një qendër emergjence kujdesi në një adresë të fshehtë, dhe u vendos që kërkuesja do të kishte një orë takim të mbikëqyrtur në javë për shkak të rrezikut që fëmija mund të rrëmbehej. Disa muaj më vonë, fëmija u largua nga qendra e kujdesit emergjent dhe u kthe tek qendra e mëparshme e kujdesit.

Në dhjetor 2012, u nxor një urdhër i ri kujdesi që u lejonte të dy prindërve takim të mbikëqyrtur për një orë, katër herë në vit dhe asnjëri prej tyre nuk e kishte të drejtën të dite vendndodhjen e fëmijës. Në vijim, në vitin 2013, Gjykata e Rrethit doli me vendim dhe urdhëroi që kërkuesja dhe babai i fëmijës nuk kishin të drejtë të kishin kontakt me të për shkak të interesit më të lartë të fëmijës pasi ekzistonte rreziku i pranishëm dhe i dukshëm i rrëmbimit. Ankimet ligjore pasuese të kërkueses dolën të pasuksesshëm.

**Ligji** – Neni 8: Bazuar në vlerësimet e provave të bëra nga gjykatat e brendshme, kishte tregues që ka patur rrezik real rrëmbimi që rridhte kryesisht nga babai i kërkueses, por nuk ishte i kufizuar tek ai. Babai i kërkueses kishte qëlluar me thikë një çift fqinj pasi ai besonte që ata kishin ndihmuar që kërkuesja të nxirrte fëmijën nga shtëpia e tyre; kërkueses i ishte thënë që babai i saj kishte ndër mend të dërgonte fëmijën në një vend tjetër, ta vriste ata dhe ti merrte fëmijën; babai i fëmijës kishte marrë kërcënime me vdekje kur ai kishte kërkuar të njihen atësia e tij; dhe një anëtar i familjes kishte ndjekur një nga prindërit kujdestarë, në përpjekje për të zbuluar vendndodhjen e fëmijës. Gjykata nuk kishte asnjë shkak për të konstatuar që gjykatat e brendshme kishin gabuar në vlerësimin e rrezikut të rrëmbimit dhe në kualifikimin e tij si ‘risk real’ në pajtim me ligjin e brendshëm. Gjykata gjithashtu pranoi që vlerësimi i autoriteteve të brendshme që pasojat e rrëmbimit do të ishin shkatërruese për zhvillimin e fëmijës, pasi ajo mund të vuante përsëri nga neglizhenca.

Në lidhje me procedurën, pasi ishte nxjerrë urdhri i kujdesit të dhjetorit 2012, çështja ishte gjykuar një herë nga Gjykata e Rrethit, dy herë nga Gjykata e Lartë dhe një herë plotësisht nga Gjykata Supreme. Përveç kësaj, ishte bërë një rishikim nga Komiteti i Lejimit të Ankimeve të Gjykatës Supreme. Trupi

gjykues i Gjykatës së Lartë ishte i përbërë nga tre gjyqtarë profesionistë, një gjyqtar jo-profesionist dhe një psikolog. Në këtë mënyrë, nuk mund të thuhet se ka patur mungesë këshillimi nga ekspertët. Kërkuesja, me këshilltarin e ndihmës juridike, ishte lejuar të paraqiste prova dhe japë dëshmi në Gjykatën e Rrethit dhe në të dyja rastet në Gjykatën e Lartë. Duke e marrë parasysh të gjithë këtë, procesi i vendim-marrjes së brendshme kishte qenë i plotë dhe kërkuesja ishte përfshirë në masën e mjaftueshme në të dhe asaj i ishte dhënë mbrojtja e duhur për interesat e saj dhe plotësisht në gjendje për tu përfaqësuar.

Gjykatat e brendshme jo vetëm kishin vlerësuar situatën e kërkueses dhe të së bijës së saj në momentin kur ajo ishte marrë nën kujdes, por ishte ndjekur në zhvillimet e mëvonshme. Në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë kishte zhvilluar një vlerësim të gjerë për zhvillimin pasues të kërkueses dhe situatës në atë moment. Kështu ishin marrë parasysh shumë aspekte të ndryshme në procesin e vendim-marrjes, jo vetëm shkalla e riskut të rrëmbimit, por edhe pasojat nëse do të ndodhte rrëmbimi, shenjat e fëmijës që tregonin neglizhencën e vuajtur, dobësitë dhe nevojat e saj, interesi e saj për njohjen e së shkuarës dhe kulturës rome dhe efektet që do të kishte kontakti për prindërit kujdestarë dhe kushtet në qendrën e kujdesit. Kështu, nuk kishte shkak për të kundërshtuar kryerjen nga ana e autoriteteve të brendshme të një shqyrtimi të thellë në masën e mjaftueshme të çështjes dhe marrjen e vendimit bazuar në atë që konsiderohej interesi më i lartë i fëmijës.

Gjykata e Lartë ishte e mendimit që risku i rrëmbimit nuk kishte të bënte me momentin kur do të ndodhnin seancat e vizitës, por edhe me rrezikun për qendrën e kujdesit familjar dhe bërjen të ditur të identitetit për familjen e kërkueses. Kështu, organizimi i këtyre seancave mund të ishte i vështirë dhe çdo numër seancash do të sillte si pasojë bërjen të ditur të informacionit në lidhje me vendin ku banonte fëmija. Megjithatë, asnjëherë nuk ishte parashikuar që do të kishte më shumë se katër seanca vizitash në vit, faktor ky që e ulte rrezikun e bërjes së ditur të vendndodhjes së fëmijës. Për më tepër, vendimi i kundërshtuar sillte rrezikun që lidhjet familjare ndërmjet kërkueses dhe së bijës së saj efektivisht të kufizoheshin. Në vendimin e saj, Gjykata e Lartë nuk e kishte përmendur shprehimisht që kërkuesja dhe e

bija e saj nuk e kishin parë njëra-tjetrën për tre vjet. Për më tepër, vendimi i Gjykatës së Lartë nuk ishte përqendruar në ribashkimin e së bijës më të ëmën e saj ose në përgatitjen për ribashkimin në të ardhmen e afërt, por më shumë në mbrojtjen e fëmijës nga rrëmbimi i mundshëm dhe pasojat e tij. Ekzistonte rrezik që fëmija mund të humbte tërësisht kontaktin me nënën e saj. Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës, ishte e rëndësishme të konsideroheshin efektet afat-gjata që mund të kishte një ndarje e përhershme e një fëmije nga nëna e saj biologjike (shih, *mutatis mutandis*, *Görgülü kundër Gjermanisë*). Ky ishte aq më shumë rasti kur ndarja e fëmijës nga nëna e saj mund të sillte tjetërsimin e saj nga identiteti i saj rom.

Në tërësi, pasojat e mundshme afat-gjata negative për fëmijën nga humbja e kontaktit nga nëna e saj dhe detyrimi pozitiv për të marrë masat për të lehtësuar ribashkimin familjar, sa më shpejt që të jetë e mundur në mënyrë të arsyeshme nuk ishin peshuar në masë të mjaftueshme të marra në balancë.

**Përfundim:** shkelje (njëzëri)

Neni 41 25,000 EUR në lidhje me dëmin jo-financiar.

## **NENI 8**

### **Neni 8-1**

#### **Respektimi i jetës private**

***Big Brother Watch dhe të tjerë kundër Britanisë së Madhe - 58170/13, 62322/14 dhe 24960/15, Vendim themeli 13.9.2018 (Seksioni I)***

Përputhshmëria me Konventën e regjimit të mbikëqyrjes së fshehtë duke përfshirë përgjimin në masë të gjerë të komunikimeve me jashtë *Shkelje*

Neni 10

Neni 10-1

Liria e shprehjes

Mbrojtja e pamjaftueshme e materialit konfidencial të gazetarit nën skemat e mbikëqyrjes elektronike: *Shkelje*

Neni 35

Neni 35-1

Shterimi i mjeteve të brendshme

Mjetet mbrojtëse efektive të brendshme

Efektiviteti i ankesës në lidhje me përputhshmërinë e përgjithshme me Konventën të një regjimi mbikëqyrës drejtuar Tribunalit me Kompetenca Hetimore: *e pranueshme*

**Fakte** - Kërkuesit, një numër shoqërisht, organizatash bamirësie, organizatash dhe individësh të përfshirë në tre kërkesa drejtuar Gjykatës, u ankuan në lidhje objektin dhe gjerësinë e programeve të mbikëqyrjes elektronike të operuara nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar. Të gjithë kërkuesit besonin që për shkak të natyrës së aktiviteteve të tyre, komunikimet elektronike mund të ishin përgjuar nga shërbimet e fshehta të Mbretërisë së Bashkuar, ose të ishin përftuar nga shërbimet e fshehta të Mbretërisë së Bashkuar pasi ishin përgjuar nga qeveritë e huaja, dhe/ose ishin përftuar nga autoritetet e Mbretërisë së Bashkuar nga Ofruesit e Shërbimeve të Komunikimeve (CSP-të).

Kërkuesit u ankuan në lidhje me përputhshmërinë me Nenin 8 të të tre regjimeve diskrete: regjimi i përgjimit në masë të komunikimeve sipas seksionit 8(4) të Rregullimit të Aktit për Kompetencat hetimore (RIPA), regjimin e ndarjes së informacioneve dhe regjimin për përftrimin e të dhënave nga komunikimi sipas Kapitullit II të RIPA-s.

Secili prej kërkuesve, në çështjen e tretë të përbashkët, kishin paraqitur një kërkesë tek Tribunali me Kompetenca Hetimore (IPT) duke pretenduar shkeljen e Neneve 8, 10 dhe 14 të Konventës. Në lidhje me përgjimet e komunikimeve të jashtme në pajtim me një urdhër të nxjerrë në pajtim me seksionin 8(4) të RIPA-s, IPT-ja konstatoi që regjimi dhe garancitë ishin të në përputhshme të mjaftueshme me kërkesat që Gjykata Europiane kishte caktuar në çështjen Weber dhe Saravia kundër Gjermanisë (dec.) për ndërhyrjen ‘në pajtim me ligjin’ për qëllimet e Neni 8 të Konventës. Megjithatë, ai gjeti dy shkelje ‘teknike’ të Nenit 8, në një rast në lidhje me mbajtjen më gjatë nga sa lejohet ligjërisht të materialit të përgjuar dhe në një tjetër mosrespektimin e duhur të procedurës së zgjedhjes për shqyrtim.

Kërkuesit e çështjes së parë dhe të dytë të përbashkët nuk kishin bërë ankim tek IPT-ja.

**Ligji** - Neni 35 (*shterimi i mjeteve të brendshme*) IPT-ja ishte një tribunal i specializuar me juridiksionin e vetëm për të shqyrtuar pretendimet e përgjimeve të padrejta të komunikimeve si rezultat i sjelljes së mbuluar nga RIPA. Ai merrte në shqyrtim përputhshmërinë e përgjithshme të regjimit përkatës të përgjimit, si dhe çështjen specifike nëse faktikisht të drejtat e kërkuesit individual janë shkelur. Atyre që u përfshinë në autorizimin dhe realizimin e urdhrit të përgjimit u kërkohet ti deklaronin IPT-së të gjithë dokumentet që ai mund të kërkonte, duke përfshirë dokumentet në lidhje me masat e brendshme për përpunimin e të dhënave që nuk mund të bëheshin publike për shkaqe të sigurisë kombëtare, pavarësisht nëse këto dokumente mbështesnin apo dobësonin mbrojtjen e tyre. IPT-ja kishte diskrecion të zhvillonte seanca gojore, publike, sipas rastit, dhe në procedime me dyer të mbyllura, ai mund të emëronte Këshilltarin për në Tribunal për të bërë parashtresa në emër të pretenduesve që nuk mund të përfaqësoheshin. Gjatë shqyrtimit të një ankese, IPT-ja kishte kompetencën të jepte kompensim dhe të nxirrte çdo urdhër që e konsideronte të përshtatshëm, duke përfshirë rrëzimin ose anulimin e çdo urdhri dhe kërkimin e fshirjes së çdo regjistrimi. Gjatë shqyrtimit të ankesës së ngritur nga kërkuesit në çështjen e tretë të përbashkët, IPT-ja i ushtroi të gjitha këto kompetenca në interes të kërkuesve.

Duke patur parasysh mënyrën se si IPT-ja kishte ushtruar kompetencat e saj në pesëmbëdhjetë vitet e fundit dhe ndikimin e vërtetë që kishin vendimet e tij mbi ligjin dhe praktikën e brendshme, shqetësimet e shprehura nga Gjykata në çështjen *Kennedy kundër Mbretërisë së Bashkuar* në lidhje me efektivitetin e saj si zgjidhje për ankesat në lidhje me përputhshmërinë e një regjimi të vazhdimet të fshehtë nuk vazhdonin të ishin të vlefshme.

Gjykata vuri re që kurdoherë që IPT-ja kishte konstatuar që një regjim vëzhgimi ishte në papajtueshmëri me Konventën, Qeveria kishte garantuar që të korrigjoheshin dhe trajtoheshin të gjitha defektet. Kështu, ndërsa provat e paraqitura nga Qeveria mund të mos demonstronin ekzistencën e një 'detyrimi të pashmangshëm' që i kërkon asaj të korrigjojë çdo

papajtueshmëri të identifikuar nga IPT-ja, Gjykata megjithatë pranoi që praktika e realizimit të konstatimeve të saj në lidhje me papajtueshmërinë e ligjit të brendshëm me Konventën ishte e sigurt në masë të mjaftueshme për tu bindur në lidhje me efektivitetin e masës korrigjuese.

Megjithatë, Gjykata pranoi që në momentin kur kërkuesit paraqiten kërkesat e tyre në çështjen e parë dhe të dytë të përbashkët, ata nuk mund të fajësoheshin që u mbështetën në çështjen Kennedy si bazë për të menduar që IPT-ja nuk ishte një instrument efektiv për një ankim në lidhje me përputhshmërinë e përgjithshme të një regjimi vëzhgues me Konventën. Kështu ajo konstatoi që ekzistonin rrethana të posaçme që i lironte këta kërkues nga kërkesa që ata të paraqisnin ankimet e tyre fillimisht tek IPT-ja.

Neni 8

(a) Regjimi i seksionit 8(4)

*(i) Parimet e përgjithshme në lidhje me masat e fshehta të mbikëqyrjes, duke përfshirë përgjimin e komunikimeve* - Në praktikën e vet gjyqësore të masave të përgjimit në hetimet penale, Gjykata ka zhvilluar gjashtë garancitë minimale të mëposhtme që duhet të parashikohen në ligj me qëllim që të shmanget abuzimi me pushtetin: natyra e veprave penale që mund të bëhen shkak për një urdhër përgjimi; përkufizimi i kategorive të njerëzve të cilëve mund tu përgjohet telefonat; një kufi kohor për përgjimin e telefonit; procedura që duhet të ndiqet për shqyrtimin, përdorimin dhe ruajtjen e të dhënave të përfthuara; masat paraprake që duhet të merren gjatë komunikimit të të dhënave palëve të tjera; dhe rrethanat në cilat të dhënat e përgjuara mund ose duhet të fshihen apo asgjësohen. Në çështjen Roman Zakharov kundër Rusisë (GC), Gjykata konfirmoi që të njëjtat gjashtë kërkesat minimale zbatoheshin edhe në çështjet ku përgjimi ishte për shkaqe të sigurisë kombëtare; megjithatë, në përcaktimin nëse legjislacioni i kundërshtuar ishte në shkelje të Nenit 8, ajo duhej të merrte parasysh masat e mbikëqyrjes së zbatimit të masave të vëzhgimit të fshehtë, çdo mekanizëm njoftimi dhe masat korrigjuese e parashikuara nga ligji i brendshëm.

Rishikimi dhe mbikëqyrja e masave të vëzhgimit të fshehtë mund të bëheshin temë diskutimi në tre faza: kur vëzhgimi është urdhëruar fillimisht, gjatë

zbatimit të tij ose pasi të jetë përfunduar. Në lidhje me të dy fazat e para, veta natyra dhe logjika e vëzhgimit të fshehtë dikton që jo vetë vëzhgimi por edhe rishikimi shoqëruar duhet të realizohet pa marrë dijeni individit. Për pasojë, meqenëse individit do të pengohet në kërkimin e një mjeti mbrojtës efektiv të zgjedhjes së tij ose të saj ose në marrjen pjesë drejtpërdrejt në çdo procedim rishikimi, ishte thelbësore që procedurat e vendosura duhet të parashikojnë garancitë e përshtatshme dhe të barasvlershme që të garantojnë të drejtat e tij ose të saj. Në një fushë ku abuzimi ishte potencialisht i lehtë në raste konkrete dhe mund të ketë pasoja kaq të rënda për shoqërinë demokratike si një e tërë, në parim ishte e dëshirueshme që kontrolli mbikëqyrës ti jepet një gjyqtari, pasi kontrolli gjyqësor ofron garancitë më të mëdha për pavarësinë, paanësinë dhe procedurën e duhur.

Në lidhje me fazën e tretë, pasi të ketë përfunduar vëzhgimi, çështja e njoftimit pasues të masave të vëzhgimit ishte e lidhur në mënyrë të pazgjidhshme me efektivitetin e mjeteve para gjykatave dhe në këtë mënyrë me ekzistencën e garancive të efektshme kundër abuzimit të tagrave monitoruese. Në parim kishte shumë pak hapësirë për t'iu drejtuar gjykatave nga ana e individëve të interesuar, përveç kur këta të fundit vihen në dijeni në lidhje me masat e mara pa dijeninë e tij ose të saj dhe në këtë mënyrë të jenë në gjendje të kundërshtojnë ligjshmërinë e tyre me efekt prapaveprues, ose, si alternativë, përveç kur çdo person i cili dyshon se është bërë objekt vëzhgimi mund ti drejtohet gjykatës, juridiksioni i së cilës nuk varet nga njoftimi i masave të marra për subjektin e vëzhgimit.

(ii) Testi që do të zbatohet - Gjykata e rrëzoi argumentin e kërkuarësve që gjashtë kërkesat minimale duhet të 'përditësohen' duke përfshirë kërkesat për provat objektive të dyshimit të arsyeshëm në lidhje me personat për të cilët janë kërkuar të dhëna, autorizimin e mëparshëm të pavarur gjyqësor për urdhrat e përgjimit dhe njoftimet pasuese të subjektit të vëzhgimit.

Ishte e qartë që përgjimi në masë ishte një mjet i vlefshëm për të arritur qëllimet legjitime të ndjekura, posaçërisht duke ditur nivelin e kërcënimit të terrorizmit global dhe krimeve të rënda. Përgjimi në masë sipas përkufizimit është pa objekt dhe të kërkuar 'dyshim të arsyeshëm' do ta bënte operacionin e kësaj skeme të pamundur. Po ashtu, kërkesa e 'njoftimit

pasues' prezumonte ekzistencën e objekteve të qarta të vëzhgimit, gjë që nuk është rasti në situatën e një regjimi të përgjimit në masë. Ndërsa Gjykata e konsideroi autorizimin gjyqësor si një garanci të rëndësishme dhe mbase edhe 'praktikën më të mirë', në vetvete ajo nuk ishte as e nevojshme dhe as e mjaftueshme për të garantuar përputhshmërinë me Nenin 8 të Konventës. Për më tepër, duket të merret parasysh operimi faktik i sistemit të përgjimit, duke përfshirë kontrollin dhe balancat e ushtrimit të kompetencës dhe ekzistencën ose mungesën e çdo prove të abuzimit faktik.

Po ashtu, Gjykata do të shqyrtonte justifikimin e çdo ndërhyrjeje nëpërmjet referencës tek gjashtë kërkesat minimale, duke i përshtatur ato sipas rastit për të reflektuar operimin e një regjimi të përgjimit në masë. Ajo gjithashtu duhej të merrte parasysh faktorët përkatës shtesë që ajo i kishte identifikuar në çështjen *Roman Zakharov*.

(iii) *Objekti i aplikimit të masave të vëzhgimit të fshehtë* - Në trajtimin e dy kërkesave të para minimale, Gjykata ishte e mendimit që dispozita përkatëse ligjore ishte e qartë në masë të mjaftueshme, duke u dhënë qytetarëve një tregues për rrethanat në të cilat dhe kushtet në të cilat mund të nxirret një urdhër sipas seksionit 8(4). Nuk kishte provë për të sugjeruar që Sekretari i Shtetit po autorizonte urdhra pa i shqyrtuar si duhet. Procedura e autorizimit i nënshtrohej një mbikëqyrjeje të pavarur dhe IPT-ja kishte juridiksion të mjaftueshëm për të shqyrtuar çdo ankesë për përgjim të paligjshëm. Gjykata pranoi që dispozitat mbi kohëzgjatjen dhe rinovimin e urdhrave të përgjimit, dispozitat në lidhje me ruajtjen, aksesin, shqyrtimin dhe përdorimin e të dhënave të përgjimit, dispozitat mbi procedurën që duhet të respektohet për të komunikuar të dhënat e përgjuara palëve të tjera dhe dispozitat për fshirjen dhe asgjësimin e materialit të përgjuar ishin të qarta në masë të mjaftueshme për të dhënë garanci të përshtatshme ndaj abuzimit.

Në lidhje me përzgjedhjen e komunikimeve për shqyrtim, pasi komunikimet të jenë përgjuar dhe filtruar, ato që nuk injoroheshin në kohën reale të afërt verifikoheshin më tej; në radhë të parë nëpërmjet aplikimeve automatike të përzgjedhësve të thjeshtë (si adresa e-maili ose numra telefoni) dhe kriterëve fillestare të verifikimit me kompjuter dhe në vijim nëpërmjet përdorimit të kontrolleve më komplekse. Përzgjedhësit dhe kriteret e kontrollit nuk është



e nevojshme të bëhen publike; dhe as të renditen në urdhrin që vendos përgjimin. Megjithatë, kriteret e kontrollit dhe përzgjedhësit e përdorur për të filtruar komunikimet e përgjuara duhet i nënshtrohen një mbikëqyrjeje të pavarur; një garanci kjo që duket se mungon në regjimin e seksionit 8(4). Në praktikë, e vetmja mbikëqyrje e procesit të filtrimit dhe përzgjedhjes së të dhënave të përgjimit për shqyrtim ishte auditimi *post factum* nga Komisioneri i Përgjimit të Komunikimeve dhe, nëse bëhet kërkesë, nga IPT-ja. Në një regjim të përgjimit në masë, kur diskrecioni për të përgjuar ishte i kufizuar në masë të konsiderueshme në termat e urdhrit, garancitë e zbatueshme për filtrimin dhe përzgjedhjen e fazës së shqyrtimit duhet të jenë më të forta.

Gjykata ishte e bindur që shërbimet e fshehta të Mbretërisë së Bashkuar i merrnin detyrimet e Konventës me seriozitet dhe nuk abuzonin me kompetencat e tyre sipas seksionit 8(4) të RIPA-s. Megjithatë, një shqyrtim i këtyre kompetencave kishte identifikuar dy sfera kryesore shqetësuese: mungesën e mbikëqyrjes së të gjithë procesit të përzgjedhjes, duke përfshirë përzgjedhjen ushtruesit të përgjimit, përzgjedhësit dhe kriteret e kërkimit për filtrimin e komunikimeve të përgjuara dhe përzgjedhjen e materialit për shqyrtim nga një analist; dhe së dyti, mungesën e çdo garancie reale të zbatueshme për përzgjedhjen e të dhënave përkatëse të komunikimit për shqyrtim. Duke patur parasysh këto mangësi, Gjykata konstatoi që regjimi i seksionit 8(4) nuk e përmbushin kërkesën e ‘cilësisë së ligjit’ dhe nuk ishte në gjendje të mbante ‘ndërhyrjen’ brenda asaj që është ‘e nevojshme në një shoqëri demokratike’.

**Përfundimi:** shkelje (pesë vota me dy)

(b) *Regjimi i ndarjes së informacioneve të fshehta* - Kjo ishte hera e parë që Gjykatës i është kërkuar të shqyrtojë përputhshmërinë e një regjimi të ndarjes së informacionit të fshehtë me Konventën. Ndërhyrja në këtë rast nuk ishte shkaktuar nga përgjimi i komunikimeve por gjendej në marrjen e materialit të përgjuar dhe ruajtjen pasuese, shqyrtimi dhe përdorimi nga shërbimet e fshehta të Shtetit të paditur. Rrethanat në të cilat materiali i përgjuar mund të kërkohet nga shërbimet e fshehta të huaja duhet të parashikohen në ligjin e brendshëm për të shmangur abuzimet

e kompetencës. Ndërsa rrethanat në të cilat mund të behej një kërkesë e tillë mund të mos jenë identike me rrethanat në të cilat një Shtet mund të kryejë vetë përgjimin, ato, megjithatë, duhet të kufizohen në masë të mjaftueshme për të parandaluar - në masën që është e mundur - Shtetet në përdorimin e kësaj kompetence për të anashkaluar ligjin e brendshëm ose detyrimet që rrjedhin nga Konventa.

Gjykata ishte e bindur që kishte një bazë në ligj për kërkimin e informacioneve të fshehta nga agjencitë e huaja të shërbimeve të fshehta, që ligji ishte i aksesueshëm në masë të mjaftueshme dhe ndiqte qëllime legjitime. Për më tepër, Gjykata ishte e mendimit që ligji i brendshëm dhe kodi tregonte me qartësinë e mjaftueshme procedurën për të kërkuar përgjimin ose dhënien e materialit të përgjuar nga agjencitë e huaja të shërbimeve të fshehta. Nuk kishte prova për ndonjë mangësi të konsiderueshme në aplikimin dhe operimin e regjimit.

**Përfundimi:** nuk ka shkelje (pesë vota me dy)

(c) *Regjimi i Kapitullit II* - Regjimi i Kapitullit II lejonte autoritete të caktuara publike të përftonin të dhëna nga Ofruesit e Shërbimit të Komunikimeve (CSP). Ligji i brendshëm, i interpretuar nga autoritetet e brendshme nën dritën e vendimeve të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Europian (GJED), kërkon që regjimi që lejon autoritetet të aksesojnë të dhënat e ruajtura në CSP-ë të kufizonin aksesin me qëllim luftën kundër 'rimeve të rënda' dhe që aksesin duhet ti nënshtrohet rishikimit paraprak nga një gjykatë ose organ administrativ i pavarur. Meqenëse regjimi i Kapitullit II lejonte aksesin tek të dhënat e ruajtura me qëllim luftën kundër krimit (dhe jo 'krimit të rëndë') dhe, përveç se kur aksesin kërkohet për qëllimin e përcaktimit të burimit gazetaresk, nuk i nënshtrohej rishikimit paraprak nga një gjykatë ose organ i pavarur administrativ, ai nuk mund të ishte në pajtim me ligjin brenda kuptimit të Nenit 8 të Konventës.

**Përfundimi:** shkelje (gjashtë vota me një)

Neni 10 Kërkuesit në çështjen e dytë të çështjeve të përbashkëta, një gazetar dhe një organizatë mbledhëse lajmesh, u ankuan në lidhje me

ndërhyrjen tek materiali konfidencial gazetaresk i shkaktuar nga operimi i të dy regjimeve të seksionit 8(4) dhe Kapitullit II.

(a) *Regjimi i seksionit 8(4)* - Masat e mbikëqyrjes sipas regjimit të seksionit 8(4) nuk synonin monitorimin e gazetarëve ose zbulimin e burimeve gazetareske. Në përgjithësi, autoritetet do të vinin në dijeni gjatë shqyrtimit të komunikimeve të përgjuara nëse janë përgjuar komunikimet e një gazetari. Përgjimi i këtyre komunikimeve nuk mund të karakterizoheshin si një ndërhyrje tepër e rëndë tek liria e shprehjes. Megjithatë, ndërhyrja do të ishte më e madhe nëse këto komunikime do të përzgjidheshin për shqyrtim dhe do të justifikoheshin vetëm 'nga një kërkesë prioritare në interes publik' nëse shoqërohej me garanci të mjaftueshme në lidhje me rrethanat në të cilat ato mund të zgjidhen me paramendim për shqyrtim dhe për mbrojtjen e konfidencialitetit nëse ato përzgjidhen, me paramendim ose jo, për shqyrtim.

Ishte tepër shqetësuese që nuk kishte kërkesa që të kufizonin kompetencat e shërbimeve të fshehta për të kërkuar materiale konfidenciale gazetareske ose të tjera (për shembull, duke përdorur adresën e e-mailit të një gazetari si një përzgjedhës), ose duke u kërkuar analistëve, në përzgjedhjen e materialeve për shqyrtim, të marrin posaçërisht në shqyrtim nëse ky material ishte i përfshirë apo mund të përfshihet. Për pasojë, do të dukej sikur analistët mund të kërkonin dhe shqyrtonin pa kufizim përmbajtjen dhe të dhënat përkatëse të komunikimeve të përgjuara.

Duke patur parasysh efektin potencial frenues që mund të ketë çdo ndërhyrje e perceptuar tek konfidencialiteti i komunikimeve dhe, posaçërisht, i burimeve të tyre mbi lirinë e shtypit dhe, në mungesë të masave të publikuara që kufizojnë aftësinë e shërbimeve të fshehta për të kërkuar dhe shqyrtuar këto materiale, përveç kur 'është e justifikuar nga një kërkesë mbizotëruese në interesin publik', Gjykata konstatoi që ka patur një shkelje të Nenit 10 të Konventës.

(b) *Regjimi i Kapitullit II* - Në shqyrtimin e ankesës së kërkuarve sipas Nenit 8, Gjykata nxori përfundimin që regjimi i Kapitullit II nuk ishte në pajtim me ligjin pasi ai lejonte akses tek të dhënat e ruajtura me qëllim luftën kundër krimit (dhe jo 'krimit të rëndë') dhe, përveç se kur akses i kërkohej

për qëllimin e përcaktimit të burimit gazetaresk, nuk i nënshtrohej rishikimit paraprak nga një gjykatë ose organ i pavarur administrativ.

Gjykata pranoi që regjimi i Kapitullit II ofronte një mbrojtje të fortë nëse të dhënat kërkoreshin për qëllimin e identifikimit të burimit gazetaresk. Megjithatë, këto dispozita zbatoheshin vetëm nëse qëllimi i zbatimit ishte përcaktimi i një burimi; por ato nuk zbatoheshin në çdo rast kur ka patur një kërkesë për të dhënat e komunikimit të një gazetari, ose kur një ndërhyrje e tillë dytësore ishte e mundur. Për më tepër, në çështjet që kanë të bëjnë aksesin tek të dhënat e komunikimit të një gazetari, nuk kishte dispozita të posaçme që të kufizojnë aksesin në lidhje me qëllimin e luftës kundër 'krimeve të rënda'. Për pasojë, Gjykata ishte e mendimit që regjimi nuk mund të ishte 'në pajtim me ligjin' për qëllimet e ankesës sipas Nenit 10.

**Përfundimi:** shkelje (gjashtë vota me një)

Gjykata gjithashtu nuk pranoi ankimet sipas Nenit 6 dhe Nenit 14 të kombinuara me Nenin 8 dhe 10 të Konventës si dukshëm të pabazuara.

Neni 41: nuk është ngritur pretendim në lidhje me dëmin.

## NENI 8

### Detyrime pozitive

***Hadzhieva kundër Bullgarisë - 45285/12***, Vendim themeli 1.2.2018 (Seksioni V)

Mosgarantimi i kujdesit për një vajzë katërmëdhjetë vjeç ndërsa prindërit e saj ishin në ndalim policor: *shkelje, nuk ka shkelje*

**Fakte** - Kërkuesja atëherë ishte katërmëdhjetë vjeç, ishte vetëm në banesë më 4 dhjetor 2002 kur punonjësit e policisë mbërritën për të arrestuar prindërit e saj në vijim të një kërkesë ekstradimi nga Turkmenistani. Prindërit e saj, të cilët në atë moment ishin jashtë, u arrestuan pas kthimit të tyre dhe u ndaluan. Kërkuesja mbeti vetëm në banesë. Ajo u ribashkua me prindërit e saj më 17 dhjetor 2002 pas lirimit të tyre me garanci financiare. Kërkuesja

në vijim kërkoi kompensim për stresin dhe vuajtjen që ajo kishte kaluar për shkak të mosorganizimit nga ana e autoriteteve të mbështetjes dhe kujdesit për të gjatë ndalimit të prindërve të saj. Duke e rrëzuar pretendimin e saj, gjykata e apelit konstatoi që edhe nëse ajo është lënë vetëm pas arrestimit të prindërve të saj, përgjegjësia për këtë nuk mund ti vishet policisë, autoriteteve të ndjekjes penale apo gjykatës, pasi nëna e saj kishte deklaruar në seancë gjyqësore më 6 dhjetor 2002, dy ditë pas arrestimit të saj, që ishte dikush që mund të kujdesej për të.

### **Ligji – Neni 8**

(a) Periudha fillestare ndërmjet arrestit dhe seancës së parë gjyqësore - Situata qartazi përbënte rrezik për mirëqenien e kërkueses, pasi ajo ishte katërmbëdhjetë vjet kur prindërit e saj u arrestuan. Sipas dispozitave përkatëse ligjore të brendshme, autoritetet kishin përgjegjësinë, mesa duket nga momenti kur prindërit e kërkueses u ndaluan, tu mundësonin atyre të merrnin masa për kujdesin e saj ose të hetonin situatën e saj me vullnetin e tyre; atyre u kërkohesh gjithashtu ti jepnin kërkueses asistencë, mbështetje dhe shërbimet që i nevojiteshin, në banesën e vet, në një qendër kujdesi apo institucion të specializuar. Qeveria nuk kishte parashtruar që ndonjë prej këtyre ishte bërë nga autoritetet përkatëse në ndonjë moment para seancës gjyqësore, dy ditë pas arrestimit të prindërve të saj. Për periudhën fillestare dy-ditore, autoritetet nuk e kishin përmbushur detyrimin e tyre pozitiv për të garantuar që kërkuesja të ishte e mbrojtur dhe me kujdesin e duhur në mungesë të prindërve.

### **Përfundimi: shkelje (katër vota me tre)**

(b) Periudha nga seanca gjyqësore deri në lirimin e prindërve - Autoritetet kompetente nuk kishin shkak për të prezumuar ose dyshuar pas seancës gjyqësore të datës 6 dhjetor 2002 që kërkuesja kishte mbetur vetëm dhe nuk kishte kujdes në mungesë të prindërve të saj. Në këto rrethana, detyrimi i tyre sipas ligjit të brendshëm për të futur fëmijët e personave të ndaluar në qendër kujdesi, nëse nuk kishin kujdes, nuk ishte relevantë pas seancës. Prindërit ishin të arsimuar, persona profesionistë me mjete të dukshme, të cilët kujdeseshin për vajzën e tyre. Asnjë prind nuk kishte vënë në dijeni ndonjë autoritet në asnjë moment që vajza e tyre kishte mbetur vetëm apo

të kishin shprehur shqetësime në lidhje me kujdesin e saj gjatë mungesës së tyre. Në fakt, nëna kishte deklaruar në gjykatë që ishte dikush që kujdesej për të. Përveç kësaj, prindërit ishin të përfaqësuar me avokat të zgjedhjes së tyre, i cili mori pjesë në seancën gjyqësore kur gjyqtari kishte hetuar në lidhje me kujdesin për kërkuesen. Avokati kishte vazhduar ti përfaqësonte ata gjatë gjithë kohës së ndalimit dhe ishte fqinj i familjes së kërkueses.

Për pasojë, në mungesë të ndonjë përpjekjeje nga ose në emër të prindërve në momentin përkatës, mbështetja e gjykatës së brendshme në protokollin e seancës së ndalimit dhe përfundimi i saj që policia, prokuroria ose gjykatat duhej të hetonin më tej në lidhje me situatën e kërkueses nuk përbën sjelljen e papërshtatshme në kontekstin e detyrimeve të tyre sipas Neni 8.

**Përfundim:** nuk ka shkelje (njëzëri)

Neni 41 3,600 EUR në lidhje me dëmin jo-financiar.

## Neni 8-1

### Respektimi i jetës private

***Libert kundër Francës - 588/13***, Vendim themeli 22.2.2018 (Seksioni V)

Pushimi nga puna për shkak të përdorimit të kompjuterit të punës për të ruajtur volume të mëdha materialesh pornografike: *nuk ka shkelje*

**Fakte** - Kërkuesi, një punonjës i shoqërisë të hekurudhave kombëtare të Francës (SNCF), u pushua nga puna në vitin 2008 në vijim të zbulimit, në mungesë të tij, të 1 562 imazheve pornografike (të total 787 megabait) në kompjuterin e punës. Kërkuesi e konsideroi këtë si një shkelje disproporcionale dhe të paligjshme të jetës së tij private, duke ditur që ai kishte shtuar mbiemrin ‘personale’ tek emri i hard diskut në fjalë (‘D:/data’).

Duke rrëzuar ankimet e tij, gjykatat ishin të mendimit si më poshtë: ‘leja për përdoruesin’ e punëdhënësit parashikonte që informacioni privat duhej të identifikohet qartazi si i tillë; termi i përgjithshëm ‘të dhëna personale’ nuk tregon në mënyrë të qartë informacion të mbuluar nga e drejta e

jetës private, posaçërisht pasi një punonjës nuk mund të përdorë të gjithë hard-diskun, i cili presumohet të mbajë të dhëna profesionale, për qëllime private; dhe pushimi nga puna nuk ishte një masë disproporcionale duke patur parasysh shkeljen e 'rëndë' të rregullave të brendshme të shoqërisë nga kërkuesi.

### **Ligji – Neni 8**

(a) Zbatueshmëria - Gjykata nuk mund të pranojë që në disa rrethana të dhënat jo-profesionale, për shembull të dhënat e identifikuara qartë si privatet, të ruajtura nga një punonjës në një kompjuter që ofrohet nga punëdhënësi i tij me qëllim që të përmbushë detyrat e tij, të mund të konsiderohet të lidhet me 'jetën e tij private'. Në rastin në fjalë, SNCF-ja i lejonte personelit të vet sipas rastit të përdorte mjetet kompjuterike të vënë në dispozicion të tyre për qëllime private, kjo në respekt të rregullave specifike.

### **(b) Themeli**

(i) Detyrim negativ apo detyrim pozitiv: ekzistenca e 'ndërhyrjes nga një autoritet publik' - duke ditur që dosjet që i përkisnin kërkuesit ishin hapur në kompjuterin e tij të punës pa dijeninë e tij dhe në mungesë të tij, Gjykata ishte gatshme të pranonte që ka patur një ndërhyrje në të drejtën e tij për respektimin e jetës së tij private. Çështja nëse këto dosje ishin identifikuar qartazi si personale trajtohet më poshtë në kuadrin e proporcionalitetit të masës.

Gjykata e rrëzoi kundërshtimin e qeverisë që SNCF-ja nuk mund të konsiderohet si 'autoritet publik' për qëllimet e Nenit 8: megjithëse aktiviteti i saj ishte 'industriale dhe tregtare' dhe personeli i saj me të kishte një marrëdhënie sipas së drejtës private, SNCF-ja ishte megjithatë një subjekt juridik i ngritur në bazë të së drejtës publike dhe ishte vendosur nën mbikëqyrjen e Shtetit, drejtorët e të cilit emëroheshin nga ky i fundit dhe ofronte një shërbim publik, kishte një monopol dhe përfundonte nga një garanci jo e drejtpërdrejtë shtetërore.

Për pasojë ndryshe nga çështja Bărbulescu kundër Rumanisë (GC) (61496/08, 5 shtator 2017, Shënim Informativ 210) – në të cilën ndërhyrja ishte kryer

nga një punëdhënës thjesht i sektorit privat - ankesa duhet të analizohet nga këndvështrimi i detyrimeve pozitive të shtetit por nga ai i detyrimeve negative.

(ii) Parashikuar në ligj - Qartazi, nenet përkatëse të Kodit të Punës parashikojnë thjesht, në një mënyrë të përgjithshme, që çdo kufizim i të drejtave dhe lirive të punëmarrësve duhet të 'justifikohet nga natyra e detyrës që duhet të ekzekutohet' dhe 'proporcionale me qëllimin e ndjekur'. Po ashtu është e qartë që në momentin përkatës praktika gjyqësore e Gjykatës së Kasacionit theksonte që përveç kur ka një rrezik serioz ose në rrethana të veçanta, punëdhënësi mund të hapë skedarët e identifikuar nga një punonjës si personale në hard diskun e kompjuterit të dhëna për përdorimin nga punonjësi në prani të këtij të fundit (ose pasi ai ose ajo të thirret në zyrë).

Megjithatë, Gjykata e Kasacionit kishte shtuar që skedat e krijuara nga punonjës nëpërmjet pajisjeve kompjuterike të dhëna atij ose asaj konsideroheshin profesionale, përveç kur punonjësi i ka identifikuar ato si personale. Ligji pozitiv në këtë mënyrë ka specifikuar rrethanat dhe kushtet në të cilat punëdhënësi mund të hapë skedat e ruajtura në kompjuterin e punës së punonjësit.

(iii) Qëllimi legjitim - Ndërhyrja synonte të garantonte mbrojtjen e 'të drejtave të të tjerëve', d.m.th., në këtë rast, ato të punëdhënësit, që mund të dojë në mënyrë të ligjshme të garantojë që punonjësit e tij të përdorin mjetet kompjuterike që ata u kanë vënë në dispozicion në kuadër të detyrimeve të tyre kontraktore dhe rregulloreve të zbatueshme.

(iv) Dosmosdoshmëria në një shoqëri demokratike - Ligji pozitiv francez përbën një mekanizëm për mbrojtjen e jetës private duke parashikuar që skedarët që janë identifikuar si personale të mund të hapen vetëm në prani të personit përkatës. Në lidhje me gjykatat, shkaqet bazuar mbi të cilat ato e kishin rrëzuar ankimin e kërkuarit në lidhje me respektimin e jetës së tij private konsideroheshin me vend dhe të mjaftueshme.

Qartësi, duke përdorur fjalën 'personale' dhe jo 'private', kërkuarisi kishte zgjedhur termin e përdorur në praktikën gjyqësore përkatëse të Gjykatës



së Kasacionit. Megjithatë, Leja për përdorimin e Kompjuterit e dhënë nga punëdhënësi përdor specifikisht fjalën ‘private’ për t’iu referuar atyre mesazheve dhe skedarëve, që punonjësit duhet ti identifikojnë në këtë mënyrë. Masa e hapësirës së ruajtjes e përdorur për qëllimet e kundërshtuara mund të kishte justifikuar një nivel të caktuar ashpërsie. Në tërësi, autoritetet e brendshme nuk e kishin tejkaluar marzhin e vlerësimit të tyre.

**Përfundim:** nuk ka shkelje (njëzëri)

## Neni 8-1

### Detyrime pozitive

#### Respektimi i jetës private

***M.L. dhe W.W. kundër Gjermanisë - 60798/10 dhe 65599/10***, Vendim themeli 28.6.2018 (Seksioni V)

Refuzimi për të detyruar medien për të anonimizuar materialin në arkivin online në lidhje me një krim me kërkesë të autorëve të tij në prag të lirit të tyre të afërt: *nuk ka shkelje*

**Fakte** - Në vitin 1993 kërkuesit u fajësuan për vrasjen e një aktori të mirënjohur dhe u dënuan me burgim të përjetshëm. Në vitin 2007, ndërsa po afrohej data e daljes së tyre nga burgu, ata nisën një çështje në ngarkim të disa organizatave të medias, duke u kërkuar që ato të anonimizonin dokumentet në arkiv të cilët mund të aksesoheshin në faqet e internetit dhe ishin të datës nga koha e gjykimit (një artikull, një dosje dhe një zbardhje e raportit audio).

Në vitin 2009 dhe 2010, ndërsa Gjykata Federale e Drejtësisë njohur që kërkuesit kishin një interes të konsiderueshëm për të mos u përballur më me fajësimin e tyre, vendosi në favor të organizatave të medias, bazuar në këto shkaqe:

- krimi dhe gjykimi kishin tërhequr vëmendje të madhe të medias në atë kohë; publiku kishte interes të informohej, gjë që përfshinte mundësinë e kryerjes së kërkimeve në ngjarjet e shkuara; kjo ishte pjesë e rolit të medias për të marrë pjesë në formimin e opinionit demokratik duke i bërë të aksesueshëm arkivat e saj;
- kërkuesit ishin përpjekur rishtas për të ri-hapur gjykimin e çështjes së tyre; jo më shumë se tre vjet para lirimit të tyre, ata i kishin bërë thirrje shtypit të transmetonte informacionin në lidhje me kërkesën e tyre të fundit për një rigjykim; deri në vitin 2006, faqja e internetit të avokatit mbrojtës të kërkuesit të dytë përfshinte shumë raporte në lidhje me klientin e tij;
- dokumentet në fjalë ishin vendosur nën tituj që tregonin qartazi që këto nuk ishin raporte të reja;
- ishte e nevojshme të merrej parasysh risku që, në mungesë të personelit dhe kohës së mjaftueshme për të shqyrtuar kërkesat për ta bërë materialin anonim, media do të hiqte dorë nga përfshirja në raportet e tyre elemente identifikues që më vonë do të ishin të paligjshëm.

Kërkuesit ishin të mendimit që ky qëndrim nuk kishte marrë parasysh mundësitë e makinave të kërkimit.

**Ligji – Neni 8:** Shkelja fillestare e jetës private të kërkuesve në këtë çështje lindi nga vendimi i organizatave të medias të përfshira në publikimin e informacionit dhe, posaçërisht, për ta mbajtur ata të disponueshëm në faqet e tyre të internetit, edhe pa patur synim tërheqjen e vëmendjes së publikut. Ekzistenca e makinave të kërkimit thjesht e përkeqësonte ndërhyrjen.

Megjithatë, detyrimet e makinave të kërkimit në lidhje me individin që preket nga një informacion i caktuar mund të jenë të ndryshëm nga ato të subjektit që e ka publikuar informacionin fillimisht. Për pasojë, balancimi i interesave konkurrues mund të sjellë rezultate të ndryshme, në varësi të faktit nëse kërkesa për fshirje është bërë në ngarkim të subjektit që e kishte publikuar fillimisht informacionin (aktiviteti i të cilit ishte në thelbin e atë që synon të mbrojë liria e shprehjes), apo në ngarkim të një makine kërkimi (interesi kryesor i së cilës nuk është publikimi i informacionit fillestar në

lidhje me personin përkatës, por lehtësimin e identifikimit të të gjithë informacionit të ofruar në lidhje me të dhe krijimin e një profili për të).

Për arsyt e renditura më poshtë, Gjykata nxori përfundimin që refuzimi për përmbushjen e kërkesës së kërkuesve nuk ishte në shkelje të detyrimeve pozitive të Shtetit Gjerman për të mbrojtur jetën private të kërkuesve. Duke patur parasysh që (i) marzhi i vlerësimit të autoriteteve të brendshme në këto çështje kur balancojnë interesa të kundërt (ii) të rëndësisë së ruajtjes së disponibilitetit të raporteve ligjshmëria e të cilëve nuk është kundërshtuar kur janë publikuar fillimisht, dhe (iii) të sjelljes së kërkuesve përkundrejt shtypit, Gjykata nuk dalloi arsye të forta që do ti kërkonin ta ndryshonin mendimin e Gjykatës Federale të Drejtësisë.

(a) Kontributi në një debat me interes publik dhe çështja e anonimizimit me kërkesë - Pavarësisht rëndësisë së tyre, të drejtat e një personi i cili ka qenë objekt i një publikimi të disponueshëm në Internet duhej të balancohej me interesin e publikut - të mbrojtur nga Neni 10 i Konventës - për të qenë i informuar në lidhje me ngjarjet në të shkuarën dhe historikun e tashëm nëpërmjet arkivave digjitale publike të shtypit.

Në këtë çështje, disponibiliteti i raporteve të kundërshtuara në faqet e organizatave të medias në momentin që kërkuesit kishin bërë kërkesat e tyre vazhdonin të kontribuonin në një debat me interes të përgjithshëm që nuk kishte rënë nga kalimi i disa viteve.

Dihet që kërkuesit nuk kërkonin fshirjen e materialit, por anonimizimin e tij. Së pari, megjithatë, qëndrimi për mbulimin e një subjekti të caktuar është një çështje që përket lirisë së gazetarit; u është lënë gazetarëve të vendosin në lidhje me hollësitë (si emri i plotë i personit përkatës) që duhet të përfshihet për të garantuar besueshmërinë e publikimit, me kusht që këto vendime të përputhen me normat etike dhe deontologjike të profesionit. Së dyti, detyrimet për të vlerësuar në një fazë të mëvonshme ligjshmërinë e një raporti në vijim të një kërkesë nga një individ i interesuar - që mund të nënkuptojë balancimin e interesave në fjalë - do të sillte rrezikun që shtypi do të preferonte të hiqte dorë nga mbajtja e këtyre raporteve në arkivat e tyre online ose nga elementet identifikues që do të prekeshin nga një kërkesë e tillë.

(b) Shkalla në të cilën personi përkatës ishte i mirënjohur dhe subjekti i raportit - Dihet që me kalimin e kohës, interesi publik në krimin në fjalë kishte rënë. Megjithatë, kërkuesit ishin rikthyer në syrin e publikut kur ata u përpoqën të rihapnin procedimin e tyre gjyqësor dhe për këtë kishin kontaktuar shtypin. Në këtë mënyrë, ata nuk ishin thjesht individë të cilët ishin të panjohur për publikun.

Në lidhje me subjektin e raporteve (zhvillimi i gjykimit penal në kohën përkatëse dhe një prej kërkesave për rihapjen e gjykimit), ky ishte në gjendje për të kontribuar në një debat në një shoqëri demokratike.

(c) Sjellja e mëparshme e personit përkatës në lidhje me medien - Përprjekjet e kërkuesve për të kundërshtuar fajësinë e tyre kishte kaluar tej aplikimit të mjeteve mbrojtëse që janë të ofruara nga e drejta penale gjermane. Si rezultat i sjelljes së tyre kundrejt shtypit, interesit të kërkuesve për të mos u përballur me fajësinë e tyre nëpërmjet mjetit të materialit të arkivuar në faqet e internetit të një numri organizatash duhet ti kushtohet më pak peshë në çështjen konkrete. Për pasojë, edhe nën dritën e lirit të afërm, ata nuk mund të kishin ndonjë shpresë të ligjshme që të anonimizohen raportet e tyre apo të harrohen online.

(d) Përmbajtja, forma dhe pasojat e publikimit - tekstet e kundërshtuara përshkruanin, në një mënyrë objektive, një vendim gjyqësor. Dihet që artikuj të caktuar në fjalë jepnin edhe hollësi për jetën e të pandehurve. Megjithatë, këto hollësi përbënin pjesë të informacionit që gjyqtarëve të së drejtës penale u kërkohet ta marrin parasysh në vlerësimin e rrethanave të krimit dhe elementëve të fajësisë individuale, dhe për pasojë në përgjithësi përbënin pjesë të diskutimeve gjatë seancave publike. Për më tepër, këta artikuj nuk reflektonin ndonjë synim për ti paraqitur kërkuesit në një mënyrë poshtëruese apo të dëmtonin reputacionin e tyre.

Në lidhje me masën e publikimeve të tyre, duke ditur pozicionet e tyre në arkitekturën e faqeve në fjalë, raportet e kundërshtuar nuk dukeshin se mund të tërhiqnin vëmendjen e atyre përdoruesve të internetit që nuk kërkonin informacion në lidhje me kërkuesit. Po ashtu, asgjë nuk tregonte që ruajtja e aksesit tek këta raporte do të kishte synimin e ri-shpërndarjes së informacionit në lidhje me kërkuesit.

Në lidhje me faktin që Interneti e intensifikon informacionin dhe e bën atë të kudondodhur - ku, pavarësisht nivelit fillestar të shpërndarjes, materiali i kundërshtuar mund të gjendet në Internet në mënyrë të përhershme, posaçërisht nëpërmjet përdorimit të makinave të kërkimit - kërkuesit nuk bënë parashtrime në lidhje me ndonjë përpjekje nga ana e tyre për të kontaktuar operatorët e makinave të kërkimit me kërkesën për të ulur gjurmueshmërinë e informacionit përkatës. Për më tepër, Gjykata ishte e mendimit që nuk ishte e nevojshme të shprehej mbi mundësinë që gjykatat e brendshme mund të kishin vendosur masa që do të ishin më pak kufizuese në lidhje me lirinë e shprehjes së organizatave të medias, duke ditur që këto nuk ishin pjesë e shqyrtimit kara këtyre gjykatave në gjykimin e brendshëm dhe as në gjykimin para Gjykatës.

(e) Rrethanat në të cilat është realizuar bërja e fotove - Fotografitë e kundërshtuara nuk përmbanin ndonjë element komprometues. Mundësia që fotografitë do të bënin palët e treta të njihnin kërkuesit ulej edhe nga fakti që ato tregonin paraqiten e kërkuesve siç kishte qenë trembëdhjetë vjet para liritë të tyre.

Përfundim: nuk ka shkelje (njëzëri)

## **NENI 10**

### **Neni 10-1**

#### **Liria e shprehjes**

***Savva Terentyev kundër Rusisë - 10692/09***, Vendim themeli 28.8.2018 (Seksioni III)

Fajësimi dhe dënimi me burgim me kusht për komente ofenduese në Internet kundër punonjësve të policisë: *shkelje*

**Fakte** - Kërkuesi, një blogger i ri, hodhi në internet një koment që i etiketonte punonjësit e policisë si ‘të trashë’, si dhe ‘përfaqësuesit më të humbur dhe të paedukuar të botës së kafshëve’ dhe duke bërë thirrje për ‘djegien

e policëve të pafe në govata sinë Auschwitz’ me qëllim që të ‘pastrohej shoqëria nga ky pisllek horrash’. Ai u shpall fajtor për nxitje urrejtjeje ndaj punonjësve të policisë si grup social dhe u dënua me një vit burgim me kusht.

**Ligji** – Neni 10: Gjykata nisi shqyrtimin bazuar në prezumimin që ndërhyrja në lirinë e shprehjes së kërkuesit ishte e parashikuar me ligj dhe që ndiqte një qëllim legjitim, që ishte mbrojtja e reputacionit dhe e të drejtave të punonjësve të policisë ruse.

Teksti në fjalë ishte përpiluar me fjalor tepër të rëndë dhe përmbante terma vulgarë, poshtërues dhe të turpshëm. Megjithatë, çështja kryesore ishte nëse deklaratimet e kërkuesit të marra si një e tërë dhe në kontekstin e tyre mund të dukeshin sikur nxisnin dhunë, urrejtje dhe intolerancë. Në këtë aspekt, komenti i kërkuesit ishte bërë në kontekstin e një diskutimi në lidhje me një çështje me interes të gjerë dhe publik, që është përfshirja e mundshme e policisë në prapësimin dhe shtypjen e opozitës politike gjatë periudhës së një fushate elektorale. Komenti kishte treguar mosaprovimin dhe refuzimin emocional të kërkuesit të asaj që ai e kishte parë si abuzim autoriteti nga policia, duke shprehur këndvështrimin e tij skeptik dhe sarkastik për standardet morale dhe etike të personelit të policisë ruse dhe mund të kuptohej si kritikë therëse për gjendjen e tashme të punëve në policinë ruse.

Megjithëse pasazhi në lidhje me ‘djegien ceremoniale të policëve të pafe në govata të ngjashme me ato të Auschwitzit ishte tepër agresiv dhe armiqësor në ton, ai, siç u konsiderua nga gjykatat e brendshme, nuk ishte thirrje për ‘asgjësimin fizik të policisë nga qytetarët e zakonshëm’, por një metaforë provokative dhe një apel emocional për ta para policinë ‘të pastruar’ nga punonjësit e korruptuar dhe abuzivë (‘police të pafe’). Në lidhje me referencën tek Auschwitzi, ndërsa të mbijetuarit dhe veçanërisht ata që ishin arratisur nga Auschwitz mund të ofendoheshin nga ky deklaram, mbrojtja e të drejtave të tyre nuk ishte përmendur nga gjykatat e brendshme tek arsyet e fajësimit të kërkuesit. Për më tepër, teksti në fjalë nuk tregonte ndonjë synim për të lavdëruar ose justifikuar praktikat naziste në Auschwitz. Nuk ishte dhënë asnjë argument mbështetës se pse punonjësit e policisë

ruse mund të konsideroheshin si të prekur nga një referencë e tillë dhe, në përgjithësi, kthimi tek nocioni i asgjësimit me flakë nuk mund të konsiderohet në vetvete si nxitje për një veprim të paligjshëm, duke përfshirë dhunën.

Duhet marrë gjithashtu parasysh që komentet e kërkuesit nuk kishin sulmuar personalisht ndonjë punonjës policie të identifikueshëm, por kishin të bënin me një institucion publik, që vështirë mund të përshkruhet si një grup në nevojë për ndonjë mbrojtje të madhe. Duke qenë pjesë e forcave të sigurisë së Shtetit, policia duhet të demonstrojë një shkallë të lartë tolerance ndaj gjuhës ofenduese, përveç kur një gjuhë e tillë nxitëse është e mundur të provokojë veprime të paligjshme të afërta në lidhje me personelin e tyre, duke i ekspozuar ata ndaj një rreziku real të dhunës fizike. Nuk kishte asnjë tregues që një koment i tillë të ishte bërë publik përkundrejt një sfondi të ndjeshëm social apo politik ose në një situatë të nderë tensioni që të përfshijë trazira kundër policisë ose rrethana të tjera që ti ekspozojë punonjësit e policisë ndaj një kërcënimi real dhe të afërt të dhunës fizike. Gjykata e brendshme, në këtë mënyrë, nuk kishin mundur të shpjegojnë se pse punonjësit e policisë si grup social ishin në nevojë të mbrojtjes së përforcuar.

Në lidhje me ndikimin potencial të komentit të kundërshtuar, gjykatat e brendshme nuk ishin përpjekur të vlerësonin nëse blogu ku kërkuesi kishte futur komentin e vet përgjithësisht vizitohej shumë apo të përcaktonin numrin faktik të vizitave të përdoruesve, të cilët kishin aksesuar blogun gjatë periudhës prej një muaji ndërsa komenti i kërkuesit kishte qëndruar i aksesueshëm. Në fakt, ishte pikërisht ndjekja penale që kishte nxitur interesin e publikut përkundrejt komentit, që fillimisht duket se kishte tërhequr pak vëmendje publike. Kërkuesi nuk ishte ndonjë blogger i mirë-njohur apo një përdorues popullor i medias sociale, dhe aq më pak të ishte ndonjë figurë publike apo me ndikim që mund të kishte tërhequr vëmendje publike dhe në këtë mënyrë të kishte përforcuar ndikimin potencial të deklarimeve të kundërshtuara. Potenciali i komentit të kërkuesit për të arritur publikun dhe në këtë mënyrë për të ndikuar mendimin e tij kishte qenë tepër i kufizuar.

Në lidhje me arsyetimin e gjykatave të brendshme, ato ishin përqendruar në formën dhe forcën e deklarimeve të kundërshtuara, pa i analizuar ato në

kontekstin e diskutimit përkatës. Për më tepër, nuk ishte bërë asnjë përpjekje për të vlerësuar potencialin e deklarimeve në fjalë për të provokuar ndonjë pasojë të dëmshme, duke i kushtuar vëmendjen e duhur sfondit politik dhe social, përkundrajt të cilit ato ishin bërë dhe objektit të efektit të tyre. Gjykatat e brendshme ishin përpjekur të merrnin parasysh të gjitha faktet dhe faktorët përkatës, dhe në këtë mënyrë shkaqet e dhëna nuk mund të konsiderohen si ‘me vend dhe të mjaftueshme’ për të justifikuar ndërhyrjen në lirinë e shprehjes së kërkuar.

Ndërsa ishin ofenduese, poshtëruese dhe virulente, deklaratimet e kërkuar nuk mund të shiheshin si përpjekje për të nxitur urrejtje kundër punonjësve të policisë ruse. Ato nuk kishin as potencial për të provokuar dhunë, duke përbërë kështu një rrezik të qartë dhe të afërt që do të kishte kërkuar fajësimin penal të kërkuar dhe dënimin me burgim me kusht. Kështu, ndërhyrja nuk ishte proporcionale me qëllimin legjitim të referuar.

**Përfundim:** shkelje (njëzëri)

Neni 41: Konstatimi i një shkeljeje përbënte kompensim të mjaftueshëm të drejtë në lidhje me çdo dëm jo-financiar.

## **NENI 11**

### **Neni 11-1**

#### **Liria e tubimit paqësisht**

***Mushegh Saghatelian kundër Armenisë - 23086/08***, Vendim themeli 20.9.2018 (Seksioni I)

Ndjekja penalisht dhe fajësimi i aktivistit pas shpërndarjes së tubimit paqësor: shkelje

Neni 5

Neni 5-1

Heqja e lirisë

Arrestimi ose ndalimi i ligjshëm



Heqja e padeklaruar e lirisë pas ‘shoqërimit’ të të dyshuarit në stacionin e policisë: shkelje

**Fakte**- Në vijim të shpalljes së rezultateve paraprake në zgjedhjet presidenciale të vitit 2008, kandidati kryesor i opozitës u bëri thirrje mbështetësve të tij për tu mbledhur në Sheshin e Lirisë në Yerevanin qendror për të protestuar në lidhje me parregullsitë e pretenduara në procesin zgjedhor. Nga data 20 shkurt të vitit 2008 dhe në vijim, u mbajtën tubime të përditshme dhe ndonjëherë tërhiqnin dhjetëra mijëra njerëz. Disa qindra demonstrues qëndruan ditë-natë, duke ngritur një kamp në shesh. Kërkuesi ishte një pjesëmarrës aktiv në tubime. Herët në mëngjesin e datës 1 mars 2008, rreth 800 policë të armatosur rëndë ndërhyjnë dhe shpërndanë demonstratën. Kërkuesi u arratis nga Sheshi i Lirisë dhe u arrestua menjëherë pas kësaj. Ai në vijim u fajësua për dy pika në akuzë të ‘sulmit mbi një oficer policie’ dhe për mbajtjen e një are me teher.

**Ligji** – Neni 5 § 1: Ndalimi i padeklaruar i një individi ishte një mohim i plotë i garancive tejet të rëndësishme të parashikuara në Nenin 5 të Konventës dhe shpreh shkeljen më të rëndë të kësaj dispozite.

Kërkuesi ishte çuar në stacionin e policisë rreth orës 6.30 të mëngjesit, më 1 mars 2008. Megjithatë, sipas protokollit të arrestit të tij, ai ishte arrestuar jo më parë se 10 30 të darkës në të njëjtën ditë. Ai ishte çuar në stacionin e policisë me forcë dhe asnjë e dhënë nuk ekziston që ai ishte i lirë të largohej. Ai ishte i kyçur në një qeli gjatë të gjithë ose një pjese të kësaj periudhe. Nuk ka asnjë shkak për të dyshuar që ndërmjet orës 6 30 të mëngjesit dhe 10 30 të mbrëmjes më 1 mars 2008, kërkuesit i ishte hequr liria brenda kuptimit të Nenit 5, par 1. Çështja ishte nëse kjo heqje lirie ishte në pajtim me kërkesën e ‘ligjshmërisë’ brenda kuptimit të Nenit 5, par 1, të Konventës.

Sipas qeverisë, deri në orën 10 30 të darkës kërkuesi formalisht nuk ishte as i ‘arrestuar’ dhe as ‘i dyshuar’ brenda kuptimit të ligjit të brendshëm, por ka patur statusin e ‘personit të shoqëruar’, pasi duket se kishte kaluar një procedurë të para-arrestit që quhet ‘shoqërim’. Asnjë nga Nenet e Kodit të procedurës Penale (KPP) nuk përmbante ndonjë rregull në lidhje me statusin e pretenduar të ‘personit të shoqëruar’. Koncepti i ‘personit të shoqëruar’ dukej se ishte zhvilluar për herë të parë nga Gjykata e Kasacionit në një

vendim të vitit 2009. Para këtij, nuk kishte ndonjë tregues që dispozitat përkatëse të KPP-së ishin interpretuar nga gjykatat vendase në një mënyrë të tillë që të parashikonin një procedurë para-arrestimi të quajtur ‘shoqërim’. As rrethanat e posaçme të çështjes së kërkuesit nuk tregonin që kjo heqje lirie para orës 10 30 e darkës kishte qenë në pajtim me një procedurë të tillë. Posaçërisht, i vetmi dokument që përmendte që kërkuesi ishte ‘shoqëruar’ ishte një protokoll i shkruar me dorë i titulluar ‘regjistri i shoqërimit’ që nuk kishte asnjë bazë në ligjin e brendshëm.

Statusi i kërkuesit ishte formalizuar vetëm 16 orë pas paraqitjes së tij të detyruar në stacionin e policisë. Gjatë kësaj periudhe kërkuesi ishte lënë pas asnjë ndjesi sigurie në lidhje me lirinë dhe sigurinë e tij personale dhe atij i ishin hequr të gjitha të drejtat e gazuara nga një i dyshuar i arrestuar sipas KPP-së, duke përfshirë të drejtën për të patur një avokat dhe për të informuar menjëherë familjen e tij. Gjashtëmbëdhjetë orët e fillimit të heqjes së lirisë së kërkuesit formalisht ishin të padeklaruara.

Për më tepër, kërkuesi kishte mbetur nën ndalim policor për të paktën 84 orë para se të nxirrej para një gjyqtari. Kjo e kishte tejkaluar periudhën maksimale të 72 orëve të lejuara nga ligji i brendshëm. Një arrest i tillë i zgjatur pa një urdhër të gjykatës për kohën që kalon afatin 72-orësh është në kundërshtim me ligjin e brendshëm.

### **Përfundim:** shkelje (njëzëri)

#### **Neni 11**

(a) Nëse ka patur një ndërhyrje në ushtrimin e së drejtës së lirisë së tubimit paqësor - Neni 11 mbronte vetëm të drejtën për ‘tubim paqësor’, një nocion i cili nuk mbulon një demonstratë ku organizatorët dhe pjesëmarrësit kanë qëllime të dhunshme. Nuk ka prova që tregojnë që demonstratat e mbajtura në Sheshin e Lirisë qysh nga data 20 shkurt 2008 përfshinin nxitje për dhunë apo të kishte ndonjë veprim dhune para operacionit të policisë të zhvilluar herët në mëngjesin e datës 1 mars 2008. Pretendimet e qeverisë që demonstruesit po planifikonin armatosjen e tyre për të nxitur trazira masive ishin të pabazuara. Nuk ka patur prova të tregonin që ishin përdorur armë

zjarri, lëndë plasëse apo armë me tej nga demonstruesit gjatë operacionit të policisë.

Pra ka patur një ndërhyrje në të drejtën e kërkuesit për lirinë e tubimit paqësor përse i takon shpërndarjes së demonstratës dhe ndjekjes, ndalimit dhe fajësimit pasues.

(b) Nëse ndërhyrja është e justifikuar - Autoritetet kishin lejuar tubimin dhe nuk kishin bërë përpjekje për ta penguar atë për nëntë ditë. Shpjegimi zyrtar i qëllimit të operacionit të policisë së datës 1 mars 2008 për të verifikuar informacionin e marrë që do të shpërndareshin armë tek protestuesit, nuk ishte i besueshëm në masë të mjaftueshme dhe Gjykata nuk kishte asnjë arsye për të dyshuar që objektivi i ndërhyrjes së policisë ishte shpërndarja e kampit dhe ata që ishin të pranishëm në Sheshin e Lirisë për të parandaluar zhvillimin e mëtejshëm të tubimit.

Qëllimi i demonstrimit nuk ishte të pengohej ushtrimi i ligjshëm i një aktiviteti nga të tjerët, por për të patur një debat dhe për të krijuar një platformë për shprehjen e një çështjeje publike me rëndësi të madhe politike që kishte të bënte drejtpërdrejt me funksionimin e një demokracie dhe përbënte një shqetësim të madh për segmente të konsiderueshëm të shoqërisë Armene. Kështu, në këtë çështje duhej të ishte demonstruar një shkallë më e lartë tolerance se ajo që u tregua nga autoritetet.

Veprimet e policisë nuk dukej se u bënë objekt i një hetimi të pavarur dhe të paanshëm. Shpërndarja e tubimit në Sheshin e Lirisë pa justifikim të mjaftueshëm dhe me sa duket pa paralajmërim për tu shpërndarë dhe me përdorimin e pajustificuar dhe të tepërt të forcës ishte një masë disproporcionale që shkonte tej asaj që normalisht mund të pritej nga autoritetet kur kufizojnë lirinë e tubimit.

Faktet mbi të cilat bazoheshin akuzat në ngarkim të kërkuesit nuk mbështetesh në ndonjë provë, ishin të përpiluar në terma të përgjithshëm dhe abstraktë, pa hollësi specifike të veprimeve që pretendoheshin se ishin kryer. Dukej se kërkuesi ishte ndjekur penalisht dhe ndaluar për shkak të pjesëmarrjes aktive dhe mbase edhe në organizimin e tubimit në Sheshin e Lirisë.

Kërkuesi ishte ndjekur dhe ndaluar për këto shkaqe për të paktën pesë muaj deri sa ranë të gjitha akuzat në ngarkim të tij, kryesisht për mungesë provash. Praktikisht në të njëjtën kohë, dolën prova dhe akuza të reja dhe kërkuesi u akuzua për sulm ndaj policisë dhe mbajtjen e një thike në mënyrë të paligjshme. Kërkuesi pretendoi që këto akuza kishin qenë artificiale dhe të fabrikuara në mënyrë që të fajësohej ai me të gjitha mënyrat meqenëse ishte aktivist i opozitës. Këto pretendime nuk dukej se ishin pa bazë. Mënyra në të cilën ishte zhvilluar çështja penale fillimisht në ngarkim të kërkuesit dhe fakti që, siç u tregua më sipër, ai ishte ndjekur penalisht dhe ndaluar për afërsisht pesë muaj për thjesht marrjen pjesë aktive në demonstratë në vetvete ngre pyetje në lidhje me motivet e ndjekjes penale të kërkuesit. Nuk ishte e qartë pse nuk ishte ngritur asnjë akuzë në ngarkim të kërkuesit për një periudhë kaq të gjatë kohe nëse në zotërim të tij ishte gjetur vërtet një thikë në ditën e parë të arrestimit.

Vendimet në çështjen penale të kërkuesit ishin thjesht një përsëritje e akt-akuzës ndaj tij, që nga ana tjetër bazohej tërësisht në dëshmitë e oficerëve përkatës të policisë. Gjykatat e brendshme nuk kishin bërë një verifikim të plotë dhe objektiv të fakteve në mbështetjeve të akuzave në ngarkim të kërkuesit dhe nuk demonstruan rigorozitetin dhe kujdesin që, në rrethanat e posaçme të çështjes dhe duke ditur kontekstin e përgjithshëm, u kërkohej të tregonin për të garantuar një zbatim efektiv të së drejtës së lirisë së tubimit paqësor të garantuar nga Neni 11. Në këto rrethana, nuk mund të thuhet që arsyet e paraqitura nga gjykatat e brendshme për të justifikuar ndërhyrjen ishin vërtet ‘me vend dhe të mjaftueshme’, të cilat i hoqën kërkuesit mbrojtjen procedurale që ai gëzonte në sajë të të drejtave të tij sipas Nenit 11.

Edhe nëse prezumohet që shpërndarja e tubimit dhe ndjekja penale, ndalimi dhe fajësimi i kërkuesit ishin në pajtim me ligjin e brendshëm dhe ndiqnin një nga qëllimet legjitime të renditura në Nenin 11, par 2 të konventës - mesa duket, parandalimi i trazirave dhe kriminalitetit - masat në fjalë nuk ishin të nevojshme në një shoqëri demokratike. Për më tepër, shpërndarja e tubimit dhe masat ndëshkuese të ndërmarra në ngarkim të kërkuesit nuk mund përveç se efektin e dekurajimit të tij në pjesëmarrjen në tubimet

politike. Pa dyshim që këto masa kishin gjithashtu edhe një potencial të konsiderueshëm për të penguar mbështetësin e opozitës dhe publikun e gjerë nga pjesëmarrja në demonstrata dhe, në mënyrë më të përgjithshme, nga pjesëmarrja në debatin e hapur politik.

**Përfundim:** shkelje (njëzëri)

Gjykata gjithashtu konstatoi, njëzëri, një shkelje të pjesës lëndore dhe procedurale të Nenit 3, duke konstatuar që Qeveria nuk kishte përmbushur detyrimin e barrës së provës dhe të bënte një parashtrim të pranueshëm dhe bindës për dëmtimet trupore të kërkuesit dhe që nuk ishte bërë asnjë hetim zyrtar posaçërisht në lidhje me pretendimet e tij për keqtrajtim. Gjykata gjithashtu u shpreh që gjykatat e brendshme nuk kishin dhënë shkaqe relevante dhe të mjaftueshme për ndalimin e kërkuesit në shkelje të Nenit 5, par 3. Përfundimisht, Gjykata konstatoi një shkelje të Nenit 6, par 1, duke konstatuar që gjykatat e brendshme kishin miratuar pa rezerva versionin e policisë për ngjarjet, nuk kishin trajtuar si duhet asnjë prej parashtrimeve të kërkuesit dhe kishin refuzuar të dëgjonin dëshmitarët e mbrojtjes.

Neni 41: 15,600 EUR në lidhje me dëmin jo-financiar.

## II. AKTGJYKIMET KUNDËR REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

***LATIFI kundër Republikës së Maqedonisë***, A. no. 19017/16, aktgjykimi i datës 17 maj të vitit 2018

### NENI 1 I PROTOKOLLIT Nr. 7

Shqyrtimi gjyqësor i papërshtatshëm i urdhrit, të bazuar në informacionin e klasifikuar të padëklaruar, për tu larguar nga vendi për shkak të sigurisë kombëtare

**Fakte** - Në vitin 1999 kërkesja u arratis nga Kosova për në Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, ku asaj iu dha azil në vitin 2005. Leja e saj e qëndrimit shtyhej çdo vit deri më 2014, kur Ministria e Brendshme e pushoi statusin e azilit, duke u shprehur thjesht që ajo ishte një ‘rrezik për sigurinë (kombëtare)’ dhe urdhëroi që ajo të largohej nga territori i shtetit të paditur brenda 20 ditëve nga marrja e vendimit përfundimtar. Gjykatat e brendshme e lanë në fuqi vendimin, duke theksuar që ai bazohej në një dokument të klasifikuar të marrë nga Agjencia e Shërbimeve të Fshta. Ato e konsideruan pa vend argumentin e kërkeses që dokumenti nuk i ishte deklaruar asnjëherë asaj.

**Ligji** - Neni 1 i Protokollit Nr. 7

(a) Zbatueshmëria - Vendimi i Ministrisë kishte efektin e pushimit të azilit të kërkeses, gjë që ishte shkaku i vetëm për qëndrim të ligjshëm. Ai përmbante një urdhër të shprehur që e detyronte atë të largohej nga Shteti i paditur brenda një afati kohor të caktuar. Ai nuk u revokua apo pezullua dhe urdhri i ekzekutimit nuk iu nënshtrua ndonjë kërkesë tjetër formale. Kërkesja kishte riskun e dëbimit në çdo kohë. Fakti që asaj i ishte dhënë një herë leje për tu larguar dhe kthyer në Shtetin e paditur dhe që urdhri nuk ishte ekzekutuar akoma nuk ishin të mjaftueshme për të nxjerrë përfundimin që urdhri nuk vazhdonte të ishte në fuqi ose që ai nuk mund të sillte dëbimin e kërkeses. Si leja për tu larguar dhe toleranca e qëndrimit

të vazhduar të kërkuarit ishin si rezultat i vendimeve të marra në ushtrim të diskrecionit të autoriteteve dhe nuk bazoheshin në ndonjë shkak ligjor. Vendimi i Ministrisë duhej të konsiderohej si një masë dëbimi, që përfshihej në objektin e Nenit 1 të Protokollit nr. 7.

(b) Themeli - Duke marrë parasysh arsyetimin e vendimit të kundërshtuar, fakti i vetëm relevant, që rridhte nga versioni i redaktuar i dokumentit të klasifikuar që ishte paraqitur para gjykatës, ishte njohuria e pretenduar e kërkuarës dhe mbështetja për përfshirjen e njerëzve të tjerë në kryerjen e shumë vjedhjeve dhe veprimeve të fshehjes. Megjithatë, nuk ka asnjë tregues të numrit ose identitetit të këtyre njerëzve ose marrëdhënies së tyre, sipas rastit, me kërkuarën. Nuk ishte dhënë asnjë hollësi tjetër faktike në mbështetje të këtyre pretendimeve dhe asnjë gjykim penal nuk kishte filluar në ngarkim të kërkuarës për pjesëmarrjen në kryerjen e ndonjë vepre penale në Shtetin e paditur apo në një shtet tjetër.

Meqenëse dokumenti i klasifikuar i përmendur më sipër nuk i ishte vënë në dispozicion kërkuarës dhe vendimi i Ministrisë nuk i dha asaj as treguesin më të vogël të shkaqeve faktike për konsiderimin e saj si risk për sigurinë, ajo nuk ishte në gjendje të bënte përfaqësimin e saj si duhet në procesin gjyqësor pasues rishikues.

Për më tepër, nuk kishte asnjë tregues që gjykatave të brendshme u ishte vënë në dispozicion dokumenti i klasifikuar apo ndonjë hollësi tjetër faktike për qëllimin e verifikimit që kërkuarja vërtet përfaqësonte një rrezik për sigurinë kombëtare. Në këtë mënyrë ato ishin kufizuar në një shqyrtim thjesht formal të urdhrit të kundërshtuar. Gjykatat e brendshme për më tepër nuk kishin dhënë asnjë shpjegim në lidhje me rëndësinë e ruajtjes së konfidencialitetit të dokumentit të klasifikuar dhe nuk ishin treguar masën e rishikimit që ato kishin kryer. Kështu ato pretendimin e ekzekutimit që kërkuarja përbente një rrezik për sigurinë kombëtare nuk ia kishin nënshtruar ndonjë shqyrtimi të plotë.

**Përfundim:** shkelje (gjashtë vota me një).

Neni 41: 2,400 EUR në lidhje me dëmin jo-financiar.

Vendimi ka marrë formë të prerë më 8 tetor 2018.

***EUROMAK METAL SHPK kundër Republikës së Maqedonisë***, A. nr. 68039/14, aktgjykimi i datës 14 qershor të vitit 2018

### **NENI 1 PROTOKOLLI nr. 1**

Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut (GJEDNJ) solli aktgjykimin në lidhje me rastin EUROMAK METAL SHPK kundër Republikës së Maqedonisë (A. nr. 68039/14), me ç'rast konstatoi shkelje të nenit 1 të Protokollit numër 1 të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut (Konventa).

Ankuesi është Euromak Metal, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar në vitin 1998, me seli të regjistruar në Shkup e cila më 16 tetor të vitit 2014 ka parashtruar ankesën deri te GJEDNJ, dhe më pas ka pushuar së ekzistuari.

Firma – parashtruese e ankesës u ankua se asaj i është cenuar e drejta e pronësisë nga ana e RM-së, meqenëse ajo ka qenë e detyruar që ta paguaj shumën e TVSH-së të cilën e ka paguar gjatë blerjes së të mirave materiale nga firmat – furnizuese të cilat nuk i kanë përmbushur obligimet e tyre ligjore që ta paraqesin dhe paguajnë TVSH-në, shumë kjo e cila më parë në pajtim me ligjin ka qenë e refuzuar gjatë heqjes së TVSH-së së firmës parashtruese të ankesës. Firma parashtruese e ankesës ka qenë e detyruar me shumë prej gjithsej 6.050.124,00 denarë, llogaritur me normën e interesit. Ajo ka qenë e çregjistruar nga Regjistri qendrorë më datën 2 shkurt të vitit 2017, kurse procedurën në emër të kësaj firme – parashtruese të ankesës para GJEDNJ e kanë vazhduar themeluesit e saj si aksionarë të vetëm, zotëri dhe zonja Pavlovski.

GJEDNJ sajoi konkludimin se edhe pse shteti nga fusha e pagesës së tatimeve posedon një marginjë të gjerë të diskrecionit, gjatë intervenimit në të drejtën e pronësisë duhet të ekzistojë “baraspeshë e drejtë” në mes interesit të përgjithshëm të bashkësisë dhe nevojës që të mbrohen të drejtat themelore të individit. GJEDNJ erdhi deri te konkludimi se masa e kontestuar e cila ka rezultuar me detyrimin tatimorë ka nënkuptuar intervenimin mbi pronësinë e firmës – parashtruese e ankesës, e cila ka pasur pritje legjitime për rikthimin e TVSH-së, duke pasur parasysh faktin se ajo ka vepruar në pajtim me të gjitha obligimet lidhur me TVSH-në. Përkatësisht, bëhet fjalë



për një kompani e cila çdo herë në kohë dhe në tërësi i ka paguar dhe i ka paraqitur të gjitha obligimet e saja tatimore, edhe nga ana e DAP nuk ka pasur kurrfarë vërejtje me vite në të kaluarën, deri në çastin kur në bazë të kontrollimit është konstatuar se firmat – furnizuese të firmës – parashtues të ankesës nuk e kanë realizuar pagesën e TVSH-së. GJEDNJ sajton konkludimin se firma – parashtuese e ankesës nuk ka qenë në dijeni e as që ka mundur të dijë se vallë furnizuesit e saj fare e paguajnë dhe e paraqesin tatimin, e as që ka marrë pjesë në ndonjë veprimtari joligjore. Prej këtui, fakti se ajo ka qenë e detyruar që për herën e dytë ta paguaj shumën e njëjtë të TVSH-së, plus normën e interesit, paraqet një barë tejet të rëndë, për faktin se ajo nuk ka qenë e detyruar që ti bartë pasojat e sjelljes së partnerëve të saj afarist.

GJEDNJ, aktgjykimin e mbështeti në bazë të qëndrimeve të cilat gjykata i ka ndërtuar në rastet dhe në rrethanat pothuajse të njëjta faktike, në rastin Bulves kundër Bullgarisë, A. nr. 3991/03, aktgjykimi i datës 22 janar të vitit 2009 dhe në rastin e Business Support Centre kundër Bullgarisë, A.nr. 6689/03, aktgjykimi i datës 18 mars të vitit 2010. Dallimi i vetëm të cilin e konstatoi GJEDNJ në mes rastit konkret dhe lëndës së Bulves kundër Bullgarisë, është fakti se në rastin maqedonas për shkak të llogarisë së bllokuar nga ana e DAP, firma parashtuese e ankesës nuk i ka paguar obligimet të cilat pasojnë nga aktvendimet e kontestuara dhe se si pasojë e kësaj firma ka pushuar së ekzistuari. Prapëseprapë, GJEDNJ konstatoi se ky fakt nuk ushtron ndikime mbi konkluzionin në raport me ekzistimin e shkeljes së të drejtës së pronësisë së firmës – parashtuese e ankesës. Duke pasur parasysh lartpërmendurën, GJEDNJ e refuzoi kërkesën e firmës parashtues për kompensimin e dëmit të shkaktuar të natyrës materiale, dhe gjykoi shumën prej 4.000 euro për kompensimin e dëmit të natyrës jo materiale, si dhe 1.500 euro për kompensim të shpenzimeve gjatë procedurës para GJEDNJ.

Aktgjykimi bëhet i plotfuqishëm më datën 8 tetor të vitit 2018.

**Konkluzion:** ekziston shkelje (njëzëri)

Neni 41: 4.000 euro për dëmshpërblim të natyrës jo materiale

***SEJDIJI kundër Republikës së Maqedonisë***, A. nr. 8784/11, aktgjykimi i datës 7 qershor të vitit 2018

### **NENI 5 (3)**

Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut (GJEDNJ), më datën 7 qershor të vitit 2018 solli aktgjykimin në lidhje me rastin Sejdiqi kundër RM-së (A.nr. 8784/11) me të cilin konstatoi shkeljen e nenit 5 paragrafi 3 të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut (KEDNJ), për shkak të mungesës së shkaqeve të mjaftueshme për vazhdimin e paraburgimit të parashtruesit të ankesës. Aktgjykimi i cili është miratuar nga ana e këshillit të përbërë nga tre gjykatësit, u bë i plotfuqishëm në ditën e miratimit të tij.

Parashtruesit të ankesës, z. Bajrush Sejdiqi, më datën 21.10.2018 i është përcaktuar masa e paraburgimit për shkak të dyshimit të bazuar se ai ka marrë pjesë në shoqërimin terrorist dhe se ka keqpërdorur pozitën dhe autorizimet zyrtare (KoK nr. 3/09). Më datën 26.12.2009 kundër tij dhe kundër 13 personave të tjerë është ngritur procedura hetimore për shkak të dyshimeve të bazuara për shoqërim terrorist, keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe për shkak të detyrimeve në lidhje me larjen e parave dhe për shkak të fitimit të pronës në kundërshtim me ligjin (KOK.nr.17/10). Në të njëjtën kohë, parashtruesit të ankesës i është përcaktuar masa e paraburgimit duke filluar nga data 25 dhjetor e vitit 2009. Parashtrësia e dorëzuar nga ana e tij ka të bëjë me paraburgimin i cili atij i është përcaktuar dhe i cili i vazhdohet parashtruesit të ankesës në kontekst të procedurës lidhur me lëndën KOK. nr. 17/10, e cila ka filluar më datën 25 dhjetor të vitit 2009, e që ka përfunduar më datën 26 janar të vitit 2011, kur parashtruesi i ankesës ka qenë i shpallur si fajtor dhe ka qenë i gjykuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, gjë nënkupton se kemi të bëjmë me paraburgimin i cili ka zgjatur një vit, një muaj dhe dy ditë.

Fillimisht, masa e paraburgimit ka qenë e bazuar në tre bazat që pasojnë nga LPP, përkatësisht rreziku nga arratia, rreziku nga mundësia e përsëritjes së veprës penale dhe rreziku nga pengimi i hetimit. Pas përfundimit të hetimit dhe pas miratimit të aktakuzës më datën 23 mars të vitit 2010, paraburgimi

i parashtruesit të ankesës ka qenë i vazhduar vetëm në bazë të rrezikut nga arratia.

GJEDNJ konstaton se gjykatat vendore gjatë gjithë periudhës së mbikëqyrur nga ana e GJEDNJ, gjatë vazhdimit të paraburgimit, vazhdimisht janë thirrur në barrën dhe rëndësinë e akuzave dhe në lartësinë e dënimit të kanosur, si dhe në elementet vendimtare. GJEDNJ vëren se gjykatat vendore vetëm sipërfaqësisht janë thirrur në faktin se parashtruesi edhe më herët ka qenë në ndeshje me ligjin, dhe gjatë kësaj duke mos theksuar konkretisht se vallë kjo ka qenë në korrelacion me procedurën paralele penale që është zhvilluar ndaj parashtruesit të ankesës, ose janë nënkuptuar lëndë të tjera penale. GJEDNJ gjithashtu vëren se në procedurën në lidhje me kërkesën për përcaktim të garancisë, gjykatat vendore janë thirrur në aktgjykimin e parashtruesit të ankesës në procedurën penale e cila është zhvilluar paralelisht, pavarësisht nga fakti se aktgjykimi i tillë akoma nuk ka qenë i plotfuqishëm, që është në kundërshtim me kërkesat e parimit të prezumimit të pafajësisë.

Qeveria gjatë përfaqësimit të lëndës para GJEDNJ ka shpalosur edhe argumente plotësuese të cilat mbështesin qëndrueshmërinë e masës së shqiptuar të paraburgimit, masë kjo e cila ka qenë e përcaktuar dhe e prolonguar edhe përkaj faktit se nga ana e parashtruesit të ankesës kjo masë në vazhdimësi ka qenë e kontestuar para gjykatave vendore. Në këtë kontekst, Qeveria shpalosi argumente dhe ofroi dëshmi për atë se parashtruesi i ankesës ka qenë i burgosur në kufirin me Kosovën, gjatë tentativës për arrati, dhe se më parë ai nuk ka qenë në qasje për organet e përndjekjes, dhe se kundër tij janë shpallur më shumë fletë arreste ndërkombëtare – fakte këto të cilat kanë qenë të njohura publikisht dhe të cilat kanë qenë në qasje edhe në mediumet kombëtare. GJEDNJ në lidhje me faktet e tilla, të cilat u shpalosën nga ana e mbrojtjes së shtetit, morri qëndrimin se të njëjtit nuk mund të merren parasysh, edhe pse pranon se të njëjtit kanë mundur të mbështetin rrezikun nga arratia e parashtruesit të ankesës, për faktin se të njëjtit nuk janë marrë parasysh nga e gjykatave kombëtare gjatë vazhdimit të masës së paraburgimit, dhe për herë të parë para GJEDNJ janë shpalosur nga ana e Qeverisë.

Në lidhje me rrezikun nga arratia, që ka mbetur si bazë e vetme sipas të cilës gjykatat e kanë vazhduar paraburgimin, GJEDNJ mori qëndrimin se rreziku nga arratia nuk mund të mbështetet vetëm në bazë të lartësisë së dënimit të kanosur, e as në faktin se nevoja për paraburgim të vazhduar mund të realizohet në mënyrë abstrakte, duke marrë parasysh seriozitetin e veprës. GJEDNJ thekson nevojën e ekzistimit të rrethanave tjera të cilat duhet të merren parasysh gjatë vlerësimit të nevojës për vazhdimin e masës së paraburgimit dhe se gjatë kësaj nuk mjafton vetëm ekzistimi i “dyshimit të bazuar” por se nevojiten edhe shkaqe tjera të cilat e cenojnë interesin publik dhe të cilët pavarësisht nga e drejta e prezumimit të pafajësisë do të dominojnë përkundër të drejtës për liri.

GJEDNJ, gjithashtu vëren se çdo aktvendim për vazhdimin e masës së paraburgimit ka qenë “i formuluar sipas skemës” me formulime identike; se nga aktvendimet nuk mund të vërehet se gjykatat vendore më mënyrë të mjaftueshme i kanë marrë parasysh rrethanat familjare të parashtruesit të ankesës, në mungesë të arsyeve se përse ka qenë e domosdoshme masa e paraburgimit në situatën kur parashtruesi në këtë shtet ka poseduar pronën dhe familjen, duke përfshirë edhe fëmijë të moshës së mitur që kanë jetuar në RM-së. GJEDNJ konstatoi se edhe në rastet kur kemi të bëjmë me aktvendime kolektive të gjykatave kombëtare, që u konstatua edhe nga vendimet e mëparshme të GJEDNJ, aktvendimet e tilla janë vetvetiu në kundërshtim me KEDNJ.

Në mënyrë plotësuese, GJEDNJ konstatoi se gjykatat vendore nuk kanë ofruar arsyetime me shkaqe relevante dhe të mjaftueshme për paraburgimin e vazhduar, gjatë kësaj duke mos shqyrtuar mundësinë e cila realisht ka ekzistuar për zbatimin e masave tjera alternative. Kështu që, GJEDNJ ka konstatuar se gjykatat vendore gjatë vlerësimit të propozimit për përcaktim të garancisë së ofruar nga ana e parashtruesit të ankesës, garanci kjo e cila ka qenë e argumentuar me një shumë të konsiderueshme të parave, gjykatat vendore janë thirrur në seriozitetin e akuzave, në lartësinë e dënimit të kanosur dhe në faktin se parashtruesi i ankesës ka qenë i gjykuar në shkallën e parë gjatë procedurës paralele, e cila për shkak të rrethanave të sqaruara më lartë, vetvetiu nuk mund të konsiderohet si shkak i mjaftueshëm. Gjatë

kësaj, GJEDNJ konstaton se Gjykata e Apelit më datën 6 dhjetor të vitit 2010 ka pranuar ankesën e parashtruesit të ankesës dhe se ka pranuar garancinë e ofruar në shumën prej 1.340.614 euro dhe se parashtruesit i ka përcaktuar masën e arrestit shtëpiak, por se Gjykata Supreme e RM-së më pas e ka anuluar këtë vendim.

**Konkluzion:** ekziston shkelje

Neni 41: 660 euro për dëmshpërblim të natyrës jo materiale

***RAMKOVSKI kundër Republikës së Maqedonisë***, A. nr. 33566/11, aktgjykim i datës 8 maj të vitit 2018

### **NENI 5(3), 5(4) dhe 6(2)**

Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut (GJEDNJ) solli aktgjykimin në lidhje me rastin Velija dhe Emel Ramkovski kundër RM-së, A.nr. 33566/11 me të cilin konstatoi shkelje të nenit 5 paragrafi 3 të Konventës Evropiane për drejtat e njeriut (KEDNJ) dhe mungesën e shkeljes së nenit 5 § 4 të KEDNJ dhe të dispozitave të nenit 6 paragrafi 2 të KEDNJ. Aktgjykimi i GJEDNJ bëhet i plotfuqishëm më datën 8 maj të vitit 2018.

Parashtruesve të ankesës z. Velija Ramkovski (“ankuesi i parë”) dhe zonjës Emel Ramkovska (“ankuesi i dytë”) iu është përcaktuar masa e paraburgimit për shkak të dyshimeve se qëllimisht për përfitime të leverdisë pronësore në kundërshtim me ligjin kanë shkaktuar veprën penale shoqërim terrorist dhe veprën penale fshehje e tatimeve, kurse për ankuesin e parë edhe veprën penale keqpërdorim të pozitës zyrtare. Gjatë hetimit dhe procedurës së mëtutjeshme penale, paraburgimi i ankuesve ka qenë i prolonguar në vazhdimësi, dhe pa suksese kanë mbetur kërkesat e ankuesve për zëvendësim të paraburgimit me masën e arrestit shtëpiak.

Më datën 23 maj të vitit 2011, ankuesit kanë parashtruar ankesën deri te GJEDNJ me pohimet se përmes paraburgimit të vazhdueshëm dhe gjatë

procedurës përkatëse gjykatat vendore i kanë shkelur të drejtat e tyre në lidhje me nenin 5 §§ 3 dhe 4 dhe të nenit 6 § 2 të KEDNJ.

GJEDNJ gjatë shqyrtimit të provave, konstatoi shkelje të nenit 5 paragrafi 3 të KEDNJ, për shkakun se gjykatat vendore nuk kanë ofruar arsyetime të përcjella me arsyetime relevante dhe të mjaftueshme për paraburgimin e prolonguar në vazhdimësi.

Në aktgjykimin e tij, GJEDNJ potencon se kërkesa për arsytet e mjaftueshme dhe relevante për përcaktimin e masës së paraburgimit, përkaj ekzistimit të dyshimeve racionale - vlen qysh gjatë sjelljes së aktvendimit iniciues, përkatësisht gjatë sjelljes së aktgjykimit të parë me të cilin përcaktohet masa e paraburgimit.

Përkaj mungesës së shkaqeve relevante dhe të mjaftueshme për vazhdimin e masës së paraburgimit në rastin konkret, GJEDNJ gjithashtu ka vërejtje në lidhje me aktgjykimet për paraburgimet kolektive dhe për lëshimet e gjykatave vendore që ti shqyrtojnë moduset alternative për sigurimin e prezencës gjatë gjykitimit, shfrytëzimin e formulimeve identike në aktgjykimet për vazhdimin e paraburgimit dhe lëshimet që të vlerësohet se vallë shkaqet dhe bazat për përcaktimin e masës së paraburgimit kanë vazhduar së ekzistuari edhe gjatë periudhës kur kjo masë ka qenë e vazhduar.

Gjykata thekson se vlerësimi i racionalitetit të kohëzgjatjes së paraburgimit nuk mund të realizohet në mënyrë abstrakte, por se paraburgimi i vazhdueshëm mund të arsyetohet vetëm në raste të ekzistimit të indikacioneve specifike për ekzistimin e interesit të posaçëm publik, i cili anon në raport të rregullit për respektim të lirisë individuale.

Ashtu që, për nga aspekti i mundësisë për arrati, GJEDNJ në aktgjykimin e saj thekson se duhet të merret parasysh karakteri i individit të përfshirë, aspektet e tija morale, lidhjet me shtetin në të cilin zhvillohet procedura dhe kontaktet e tij me shtetet e huaja. Për nga aspekti i mundësisë për arrati, përkaj faktit se mundësia e tillë duhet të përcaktohet me një dozë të mjaftueshme të bindjes, mes tjerave mundësia e tillë duhet të jetë edhe reale, kurse masa të jetë përkatëse duke pasur parasysh historinë dhe karakterin e individit të përfshirë. Në lidhje me provat që kanë të bëjnë me

ankuesin e dytë, të shpalosura për herë të parë në mbrojtjen e shtetit para GJEDNJ, GJEDNJ mori qëndrimin se të njëjtit janë irelevante për vlerësimin e provave të dhëna nga ankuesit për shkeljen e KEDNJ për shkakun se gjykatat vendore nuk i kanë theksuar lidhjet e fuqishme të ankuesit me Turqinë si shkak i cili e arsyeton paraburgimin e saj në bazë të rrezikut nga arratia. GJEDNJ për nga aspekti i faktit se i biri i ankuesit të parë dhe vëllai i ankuesit të dytë, ka qenë i arratisur dhe qëndrimi i gjykatave vendore se kjo dhe arratia e disa bashkë të akuzuarve të tjerë e zmadhon rrezikun e arratisjes, morri qëndrimin se sjellja e personave të cilët kanë qenë bashkë të akuzuar nuk mund të paraqet faktorin vendimtarë gjatë vlerësimit të mundësisë për arratisjen e ndonjë personi tjetër, por se vlerësimet e tilla duhet të bazohen në rrethanat personale të individit të përfshirë.

GJEDNJ, gjithashtu konstaton se në kontekst të rrezikut nga arratia, përskaj referimit në mënyrë abstrakte të “pronës dhe lidhjeve familjare”, gjykatat vendore nuk kanë potencuar asnjë aspekt specifik të karakterit të ankuesve, sjelljes së tyre ose të rrethanave të cilat do ta arsyetonin konkluzionin e tyre për ekzistimin e rrezikut të vazhdueshëm të arratisjes; se nuk i kanë adresuar provat e ankuesve për mungesën e rrezikut nga arratia, për shkak të lidhjeve të fuqishme familjare të tyre, fakti se të njëjtit nuk i janë kundërshtuar privimit nga liria dhe se ata nuk kanë tentuar që të arratisen; mungesa e çfarëdolloj arsytimi përse në rastin konkret, nuk janë siguruar masa alternative dhe më pak invazive që të sigurohet prezenca e të akuzuarve.

Në kontekst të provave të theksuara në aktgjykimet se bëhet fjalë për një vepër të organizuar, GJEDNJ vëren se një gjë e tillë vetvetiu duke mos i theksuar karakteristikat personale dhe sjelljet, nuk mund të paraqesë arsyetim për paraburgimin e gjatë dhe në kuptimin se gjykatat vendore nuk e kanë marrë parasysh faktin se ankuesit më parë nuk kanë pasur dosje penale.

Gjatë kësaj GJEDNJ edhe pse pranon se pozitat udhëheqëse të cilat ankuesit i kanë pasur në personat juridik të involvuar në ngjarjen penale – juridike, paraqesin faktorë relevantë gjatë vlerësimit të mundësisë për përsëritjen e veprës, prapëseprapë konstaton se edhe nën supozimet se rreziku i tillë ka ekzistuar në mënyrë initiale, pas një periudhe të caktuar kohore, thirrja në

këtë argument ka kërkuar sqarime plotësuese, gjë të cilën gjykatat vendore e kanë anashkaluar që ta theksojnë dhe në këtë mënyrë të dëshmojnë dhe të përcaktojnë me siguri të mjaftueshme ekzistimin e mundësisë për përsëritjen e veprës.

**Konkluzion:** ekziston shkelje 5(3)

Në këtë rast GJEDNJ konstaton mungesën e shkeljes së nenit 5 § 4 të KEDNJ. Përkatësisht ankuesit u ankuan se Gjykata e Apelit nuk ka vendosur me shpejtësi të mjaftueshme në lidhje me ankesat e tyre, të parashtruara kundër aktgjyqimit për vazhdim të paraburgimit. GJEDNJ pasi që konstatoi se në rastin konkret për të cilin janë ankuar ankuesit, Gjykata e Apelit ka vendosur në lidhje me ankesën 11 ditë pas miratimit të tij, kurse vendimi njërit prej akuzuarve i është dorëzuar në ditën e 14 – të pas dorëzimit të ankesës, kur mbrojtësi i tyre në të njëjtën kohë ka realizuar shqyrtimin në lëndën përkatëse, GJEDNJ konstatoi se afatet e tilla nuk janë në kundërshtim me kërkesën për vendosje “të shpejtë” e që janë në lidhje me nenin

5 § 4 të KEDNJ.

**Konkluzion:** nuk ekziston shkelje 5(4)

GJEDNJ konstatoi se në rastin e shqyrtuar nuk ekzistojnë shkelje të asnjërës prej dispozitave të përfshira në nenin 6 paragrafi 2 të KEDNJ. Përkatësisht, ankuesit kanë theksuar se gjykatat vendore kanë shkelur të drejtën e tyre për pandehje të pafajësisë me faktin se në vendimin e datës 22 mars të vitit 2011 për vazhdimin e paraburgimit të ankuesve, këshilli i përbërë nga tre anëtarët, mes tjerave, ka theksuar se “të akuzuarit i kanë kryer veprat penale si një grup mirë i organizuar dhe kompakt”; “duke pasur parasysh shkallën e rrezikut për shoqërinë dhe përgjegjësinë penale” dhe se “disa prej veprave penale janë realizuar si vepra të vazhdueshme penale”.

Duke bërë dallimin në mes deklaratave që reflektojnë mendimin se personi i përfshirë është fajtor (që lëndojnë të drejtën për pandehje të pafajësisë) dhe deklaratat të cilat thjeshtë e përshkruajnë “gjendjen e dyshimit” (të cilat konsiderohen si të pranueshme për praktikën gjyqësore të GJEDNJ); dhe duke i analizuar deklaratat kontestuese që janë në kontekst, GJEDNJ konstaton se deklaratat e kontestuar që janë shfrytëzuar me qëllim që të



arsyetohet vazhdimi i masës së paraburgimit të ankuesve në bazë të rrezikut nga arratia dhe të rrezikut të përsëritjes së veprës, gjatë kësaj gjykatat vendore janë thirrur në dyshimin e bazuar se të akuzuarit i kanë kryer veprat penale për të cilat kanë qenë të akuzuar dhe se rrethanat e kontestuara kanë qenë të trajtuara jo si fakte të përcaktuara, por vetëm si prova. GJEDNJ nuk sajoi konkludimin se deklaratat e kontestuara kanë përfshirë në vete deklaratat eksplicite dhe jo përkatëse me të cilat do të konstatohej fajësia e ankuesve, para se të njëjtit të shpallen si fajtorë në procedurën përkatëse. Përkundrazi, GJEDNJ konstatoi se në kontekstin e lartpërmendur ekzistojnë deklaratat të cilat në mënyrë të qartë tregojnë se ankuesit kanë qenë të dyshuar dhe se gjykatat vendore nuk e kanë shqyrtuar çështjen se vallë fajësia e ankuesve mund të konfirmohet nga dëshmitë, por se vallë ka ekzistuar baza juridike për vazhdimin e masës së paraburgimit.

Për shkeljet e konstatuara të KEDNJ, GJEDNJ secilit prej parashtruesve të ankesës i përcaktoi shumën me nga 780 euro si dëmshpërblim të natyrës jo materiale.

**Konkluzion:** Nuk ka shkelje 6 (2)

Neni 41: 780 euro për dëmshpërblim të natyrës jo materiale për secilin prej ankuesve

***SMIČKOVSKI kundër Republikës së Maqedonisë***, A. nr. 15477/14, aktgjykimi i datës 5 korrik të vitit 2018

### **NENI 6 §§ 1 dhe 3 (ç)**

Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut (GJEDNJ) më datën 5 korrik të vitit 2018 solli aktgjykimin në lidhje me rastin Smičkovski kundër RM-së (A. nr. 15477/14) me të cilin konstatohen shkelje të nenit 6 paragrafi 1 dhe 3 (ç) të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut (KEDNJ).

Aktgjykimi bëhet i plotfuqishëm në ditën e miratimit meqenëse për të njëjtin ka vendosur këshilli i përbërë prej 3 gjykatësve.

Parashtruesi i ankesës është Damjan Smičkovski i lindur në vitin 1993, kundër të cilit është iniciuar procedura penale për shkak të rrahjes fizike në një klub nate në Shkup, në të cilën rrahje kanë marrë pjesë parashtruesi i ankesës dhe personi R., si dhe disa të rinj të tjerë. Si pasojë e kësaj rrahjeje, personi R., ka pësuar me lëndime (të cilat më vonë përmes ekspertizës së kryer nën urdhrin e gjykatësit hetues, kanë qenë të klasifikuara si lëndime të rënda trupore) dhe i njëjti ka qenë i dërguar në institucionin shëndetësorë prej nga më vonë po të njëjtën mbrëmje ai ka qenë i lëshuar.

Sipas shënimit zyrtarë të MPB-së, bëhet fjalë për një incident në të cilin kanë marrë pjesë parashtruesi i ankesës dhe R, si dhe personi P. Gjykatësi hetues ka hapur hetimet dhe në pyetje i ka marrë parashtruesin e ankesës, personin R., si dhe dëshmitarët J. dhe K. të cilët kanë qenë miq të personit R. Të gjithë këta kanë pohuar se në incidentin personi R. ka qenë i sulmuar nga ana e parashtruesit të ankesës. Në procedurën hetimore, parashtruesi i ankesës ka theksuar se ai ka vepruar në vetëmbrojtje dhe se ai në fakt ai ka qenë i sulmuar nga personat R., J. dhe K. Ai ka kërkuar që të merret në pyetje edhe miku i tij P., për të cilin ai ka pohuar se i njëjti ka qenë dëshmitarë okularë i këtij rasti.

Pas kësaj, parashtruesi i ankesës ka qenë i akuzuar për shkaktimin e lëndimeve të rënda trupore. Prokurori ka propozuar marrjen në pyetje të personave R., J. dhe K. dhe pranimin si dëshmi raportin e mjekësisë ligjore të përpiluar në kërkesë të gjykatësit hetues.

Në parashtrësën e dhënë në lidhje me aktakuzës, parashtruesi i ankesës ka kërkuar që të merret në pyetje edhe personi P, si dëshmitarë okularë si dhe dy dëshmitarët tjerë M.K (si dëshmitarë okularë i ngjarjes) dhe B. (të cilët është propozuar që të merret në dëgjim në lidhje me rrethanat kur parashtruesi i ankesës edhe më parë ka qenë cak i sulmit nga po i njëjti grup, të cilin personi B. e ka penguar). Parashtrësja ka qenë e refuzuar.

Gjatë procedurës penale para gjykatës gjykuese, parashtruesi i ankesës disa herë ka kërkuar që të merren në dëgjim personat P. dhe M.K., si dhe personi M.R., dhe njëherit është kërkuar “ekspertizë e re” për nga aspekti i lëndimeve fizike të cilët i ka pësuar personi R., si dhe ekspertiza e gjendjes psikike të parashtruesit të ankesës gjatë kohës së ngjarjes.

Gjykata gjykuese dy herë me radhë e ka refuzuar propozimin e dhënë nga parashtruesi i ankesës për marrjen në dëgjim të personave P. dhe M.K., me arsyetimet identike se të njëjtit nuk kanë qenë dëshmitarë okularë të ngjarjes, dhe vendimin e njëjtë e ka miratuar edhe për propozimin që të merret në dëgjim personi M.R. Gjithashtu, gjykata gjykuese ka vërejtur se personi M.K., nuk ka qenë i përmendur më parë në deklaratat të cilat kanë qenë të tubuara gjatë procedurës. Gjykata gjykuese gjithashtu i ka refuzuar kërkesat për “ekspertizë të reja” me arsyetimin se gjykata disponon me dëshmi të mjaftueshme për përcaktimin e gjendjes faktike.

Pas kësaj, parashtruesi i ankesës ka qenë i dënuar në bazë të raportit të mjekësisë ligjore, deklaratave të dhëna nga ana e R.J dhe K., edhe pse ai ka pranuar se në këtë ngjarje ka qenë i përfshirë edhe personi i tretë, një mik i ankuesit, gjykata ka konkluduar se argumentet e mbrojtjes kanë qenë në kundërshtim me dëshmitë tjera të cilat në masë të mjaftueshme kanë argumentuar fajësinë e parashtruesit të ankesës.

Parashtruesi i ankesës ka parashtruar dy ankesa me arsyetime “inter alia” se gjykata gjykuese nuk ka lejuar asnjërin prej dëshmive të propozuara nga ana e mbrojtjes, duke përfshirë edhe kërkesën për ekspertizë të re mjekësore në lidhje me lëndimet prej nga pason edhe kualifikimi i veprës. Prokuroria në përgjigjen e saj ka theksuar se ankesat duhet të pranohen, kurse lënda të rikthehet në shqyrtim dhe vendosje të sërishme për shkak të lëshimeve të bëra nga ana e gjykatës gjykuese në lidhje me ekspertizën e lartpërmendur. Prapëseprapë, Gjykata e Apelit i ka refuzuar ankesat me konkluzionin se personi P. nuk ka qenë dëshmitarë okularë i kësaj ngjarjeje, gjë që pason nga deklaratat e dhëna nga ana e parashtruesit të ankesës gjatë hetimit, si dhe për shkak të faktit se gjendja faktike i është përcaktuar në bazë të deklaratave të dhëna nga ana e personave R. J. dhe K., të cilat kanë qenë konsistente.

Parashtruesi i ankesës u ankua para GJEDNJ se atij nuk i është mundur që në mënyrë efikase ta prezantoj rastin e tij për faktin se ai nuk ka pasur mundësi në kushte të njëjta sikur edhe prokuroria ta sigurojë shpalosjen e dëshmive gjatë mbrojtjes së tij.

Gjatë konstatimit të shkeljeve të nenit 6 §§ 1 dhe 3 (ç) të KEDNJ, GJEDNJ pati parasysh se:

- Parashtruesi i ankesës ka pohuar se ai ka qenë i sulmuar nga personat R. J. dhe K., dhe se ai ka vepruar në vetëmbrojtje;
- Parashtruesi i ankesës ka pohuar se dëshmitari P., ka qenë i pranishëm së paku në një pjesë të ngjarjes dhe se ai ka marrë pjesë në të këtë ngjarje;
- Për dallim nga M.K. dhe M.R. të cilët edhe pse kanë qenë të propozuar si dëshmitarë okularë të ngjarjes nga ana e parashtruesit të ankesës, më vonë gjatë procedurës, ankuesi ka insistuar që të dëgjohet personi P., nga vetë fillimi i procedurës;
- Nga shënimet e dhëna nga ana e MPB-së, e që janë shfrytëzuar si dëshmi gjatë procedurës, pason se personi P., ka marrë pjesë në këtë ngjarje;
- Konstatimi i fundit pason edhe nga deklarata e dhënë nga ana e personit J., të cilën gjykata gjyqësore e ka vlerësuar si të besueshme;
- Dy instancat gjyqësore vendore kanë pranuar faktin se miku i parashtruesit të ankesës ka qenë i pranishëm në këtë ngjarje.

Në mënyrë plotësuese, për nga aspekti i pohimeve të mbrojtjes së ankuesit se ai ka vepruar në vetëmbrojtje dhe se ai ka qenë i sulmuar nga ana e personit R., dhe nga ana e shokëve të tij, dhe jo e kundërta, si dhe për nga aspekti i dëshmive tjera, GJEDNJ ka sajuar konkludimin se kërkesa e parashtruesit të ankesës për dëgjimin e personit P., që ka pasur për qëllim hedhjen poshtë të deklaratave të dhëna nga ana e dëshmitarëve të prokurorisë, e njëjta ka qenë mirë e argumentuar dhe relevante për lëndën e akuzës dhe në mënyrë të qëndrueshme ka mundur të fuqizojë pozitën e mbrojtjes ose edhe të rezultojë me lirimin e ankuesit, dhe se e njëjta nuk ka qenë e pabazë.

GJEDNJ në drejtim të kësaj ka konstatuar se kërkesa e parashtruesit të ankesës për dëgjimin e dëshmitarëve në mbrojtjen e tij, ka qenë e refuzuar me arsyetimin se asnjëri prej dëshmitarëve të propozuar nuk ka qenë dëshmitarë okularë i kësaj ngjarjeje dhe se të gjitha faktet relevante në masë të mjaftueshme kanë qenë të konstatuara me dëshmitë e ofruara. Në këtë kontekst, GJEDNJ konstaton se kjo bie ndesh me:

Deklaratën e dhënë nga ana e parashtruesit të ankesës para gjykatësit hetues dhe me deklaratën e dhënë nga personi J., duke pasur parasysh faktin se që të dy kanë pohuar se personi P., ka qenë i pranishëm së paku në një pjesë të ngjarjes juridiko – penale, gjë që gjithashtu konfirmohet edhe nga shënimet policore. Prej këtui, GJEDNJ sajoi konkludimin se refuzimi i propozimit për dëgjimin e personit P., në cilësi të dëshmitarit të mbrojtjes, ka qenë në kundërshtim me faktet e këtij rasti, dhe se arsyetimet e dhëna nga ana e gjykatave vendore në këtë drejtim, nuk mund të konsiderohen si të vlefshme dhe relevante.

Për shkak të lartpërmendurës, GJEDNJ konkludon se me refuzimin e të gjitha dëshmive të cilat janë propozuar nga ana e mbrojtjes, në veçanti propozimi për dëgjimin e personit P., si dëshmitarë, pa arsye relevante, dhe në të njëjtën kohë duke i pranuar të gjitha argumentet dhe dëshmitë e propozuara nga ana e prokurorisë, gjykata gjykuese ka krijuar një avantazh të padrejtë në dobi të prokurorisë dhe me këtë e ka privuar ankuesin nga çdo mundësi praktike që në mënyrë efikase ta kontestoj akuzën kundër tij.

Duke konstatuar shkeljet për shkak të shkaqeve të lartpërmendura të nenit 6 §§ 1 dhe 3 (ç) të KEDNJ, GJEDNJ ka sajuar konkludimin se nuk nevojitet që ti vlerësojë pohimet tjera të ofruara nga parashtruesi i ankesës në lidhje me shkeljen e nenit 6 të Konventës, e që janë në lidhje me drejtësinë e procedurës penale të drejtuar kundër tij.

Me aktgjykimin, GJEDNJ, parashtruesit të ankesës i përcaktoi dëmshpërblimin në shumën e përgjithshme prej 3.150 euro (2.400 për kompensimin e dëmit të natyrës jo materiale dhe 750 euro për kompensim të shpenzimeve në procedurën vendore dhe për procedurën para GJEDNJ).

**Konkluzion:** ekziston shkelje (njëzëri)

Neni 41: 2.400 euro për dëmshpërblim të natyrës jo materiale

# IRZ



Makavej, 2019